

TASİM T. ALİAJ



**GLADIATORI
I MUNDUR**

891. P83 -7
A 58

TASIM T. ALIAJ

S

Gladiatori i mundur

~~Fo 5+8~~

20042

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KAMPIONI I AUSTRALISË

Kampionati po afrohej nga dita në ditë, ndër厮a ne nuk kishim plotësuar ende peshat. Me të tjerat bëmë si bëmë, ama për peshën e rëndë meazallah se gjendej njeri.

Në fillim e patëm të vështirë edhe për uniformën sportive. Asnjë nga boksierët nuk pranonte të dilte me të mbathura allafrënga dhe hajt t'u mbushje mendjen se sporti qe sport. Më në fund këtë bela e zgjidhëm duke dalë në ring me të mbathura treçerekshë (një pëllëmbë nën gju).

Sa për peshën e rëndë asgjë nuk po bënim dot. Morëm gjithfarë kandidatësh, por në peshim na dilnin të gjithë eksiq. E ku të gjeje atëherë një njeri aq të shëndoshë dhe aq të mbajtur!

Vetëm Zoti Ahmet Resuli mund të plotëson-te, me siguri, peshën e rëndë. Ai peshonte aq shumë, saqë trembte gjithë kuajt e arabave të Tiranës, të cilët apo e shihnin, turfullonin dhe ngulnin këmbët për të mos i shkulur nga vendi. Por zoti Ahmet ishte deputet, dhe nuk para i vinte

ndoresh boksi. Tjetër gjë pastaj kur në parlamen-
ttrashej puna sa nuk merrte vesh i pari të
dytin. Atje ai për çdo të papandehur, kish bas-
tunin me dru lisi.

Por ne e kishim vështirë të hiqnim dorë nga
pesha e rëndë.

Një ditë shkova të qethem, si zakonisht, te
xha Bequa. Po për habinë time, në vend të xha
Beqos, gjeta një alamet binaje sa dy njerëz bash-
kë. U futa i hutuar në dyqan, ndërsa berberi më
ftoi me dashamirësi të ulem.

— Më fal — i thashë, — po xha Bequa?

— Është si pa qejf. Unë jam i nipi, berber
në Durrës. Erdha të rri ca ditë te xhaxhai. Sot
dola për mos t'u larguar myshterinjtë.

— Ke bërë shumë mirë — i thashë dhe u ula
si mbi gjemba. Por nipi i xha Beqos kish dorë të
lehtë dhe gojën mjaltë. Kish mbushur tridhjet
vjet, por shëndeti e tregonte më të madh. E shiko-
ja me vëmendje.

— A je marrë ndonjëherë me boks? — e pyeta.

— Me boks? Jo, zotëri. Unë jam berber. Nuk
di zanat tjetër. A të nxjerr ndonjë metelik ky za-
nat që më thua?

— Boksi nuk është zanat, por sport — e
sqarova.

— Aha, qenka sport! Aq më keq. E ku kemi
kohë ne të merremi me sport? Dhe ajo na duhet!

— Po sikur ta provojmë? — e pyeta i vendosur.

— Bah! Ç'më duhet mua ai sport kur kam
zanat.

Aty për aty nuk bëra dot gjë. Po, kur shko-
va pas dite në stërvitje, u tregova shokëve dhe

trainerit pér nipin e xha Beqos. Ata, tē gëzuar, pas praktikës, e mbushën plot floktoren e xha Beqos. Filluan t'ja bënин mendjen sallatë berberit tē ngratë.

— Do bëhesh kampion i vendit pa ngrënë asnjë grusht!

— Jo, pér besë, një grusht me para e desha. Kam kalamaj.

— Ajo është punë, që rregullohet!

— Ti je i fortë, meqë gjithë ditën rri më këmbë!

— Ti me këto duar mund tē mbytësh një dem!

Kështu, Ismailit, nipit tē xha Beqos, iu mbush mendja tē merrej me boks, katër ditë para se tē hapej kampionati.

Ne bashkë me trainerin filluam ta udhëzonim tē gjithë përnjëherë, duke dashur që ai tē përfittonte sa më tepër. Por më tepër e hutonim. Kësh-
tu, atë që mezi ja fuste në kokë njëri, ja prishte tjetri. Por Ismaili ishte i urtë; ai nuk dinte t'ja prishte njeriut. Si t'i thoshnim ne bënte. «Më paçi
në qafë» na tha vetëm një herë në fillim dhe pas-
taj bënte si i thoshnim.

Ismaili ish me tē vërtetë i fortë, por ama te-
për i ngathët. Duhej rrotulluar me motor. Nga tek-
nika jo vetëm që ishte fare esëll, por asgjë nuk i
futej në kokë.

U nisëm pér në qytetin ku do tē zhvillohej kampionati. Sa zbritëm, u interesuam pér gjë-
ndjen. Vetëm një ekip kish boksierë tē peshës së rëndë, përveç nesh. Pra Ismaili, sapo zbriti
nga maqina, e siguroi vendin e dytë në kampionat.

Ne pastaj filluam të interesoheshim pér kundërshtarin e Ismailit. Dhe ja ç'mësuam. Ai sapo kish kaluar nga xhandërmaria në kasaphanë. Dy ditë para nisjes e kishin marrë pér në boks. Edhe atij ja kishin trubulluar mendtë me titullin e kampionit.

— Ti, që me një dorë i ngul hanxharin pér vdekje goxha bualli, të mos rrahësh një njeri! — i kish thënë, midis të tjerash, trainieri i tyre.

Kështu edhe kasapi kish vendosur të merrte titullin kampion, duke i lënë pér disa ditë thikët dhe hanxharët.

Ndeshjet, si gjithmonë, filluan nga peshat e para. U thyen hundë e turinj, si zakonisht; u duartrokitim dhe u vërvhëlliyem.

Pér ditën e fundit qe lënë ndeshja e peshës së rëndë si dhe ceremonia e mbylljes së kampionatit.

Një ditë përpëra kësaj, traineri ynë takoi, si rastësish, kasapin.

I kish dhënë një cigare pastaj e kish pyetur si me mos përfillje.

— A je marrë ndonjëherë me boks?

— Jo. Po zotrote?

— Unë? He, he, unë me boksin e kamë nxjerrë bukën deri tanë. Po ti, mor djalë i mirë, a e di se ke një kundërshtar shumë të fortë? Si guxon të matesh me të në ring, kur nuk qenke marrë asnjëherë me boks?

— Ashtu thua? — ja ktheu me gjysmë zëri tjetri. — Jo, more, pse, aq i fortë qënkërka kundërshtari im?

— Po! Ai s'ka as dy javë që është kthyer nga Australia. Atje bëhej boks, jo shaka. Kër-

ciste nofulla si tē qe cifël. Dhëmbët tē shkoqeshin si kokrra shege. Eh, tē dëgjosh ç'tregon kundërshtari yt!

— Edhe ai ka shpëtuar gjallë? — pyeti me habi kasapi.

— Shpëtuar, the? Ai ishte kampion, mor bablok. Me atë s'guxonte kushdo tē dilte në ring. Ai iua këndonte kulufruthin pa e zgjatur. Ai mërzitet pér kiamet në ring dhe zakonisht i jep fundi pas katër apo pesë goditjesh. Ama po qe se kundërshtari e qëllon, tërbohet fare. Atëherë nuk e lë tē dalë nga ringu pa e ngordhur me grushtë. Si e shqep mirë e mirë kundërshtarin kësisoj, del gjithmonë fitimtar. Ai në Australi ka qenë kampion i kontinentit.

— Ashtu, ë? Po pse ka ardhur këtë — pyeti me gjysmë zëri, si pa dashur, kasapi, në fytyrën e tē cilit nuk kish mbetur pikë gjaku.

— U mërzit! — thotë. — Pastaj ç'të bënte më? Para fitoi pa hesap. Asnjë boksier nuk guxonte tē matej me tē. Dhe ata pak, që kuturisnin, ai i kastandiste pér ujë tē kripur. Erdhi këtu që tē shohë se mos vallë po gjendet ndonjë burrë néné tē matet me tē. Sidoqoftë ti mos u mërzit dhe mos u tremb kështu — i tha trainieri ynë kasapit, kur vërejti se atij sa nuk po i binte tē hollët. — Ai nuk do tē tē qëlloj. Do ta porosit vetë. E shumta një ose dy grushte sa pér t'u gjendur në muhabet. Veç ki kujdes tē mos e qëllosh. Ndryshe, gjynah mos pastë. Po e qëllove, ai pastaj nuk e mban dot veten. Ka mundësi që vetëm me një grusht tē mos luash më nga vendi. Ai është tip nevriku.

Sapo që kasapi u nda me trainerin, bëri tutje

më të dalë të qytetit, me shpresë se mos gjente ndonjë maqinë për t'u kthyer me të shpejtë në shtëpi. Në djall të vente boksi bashkë me titullin kampion. Kish më tepër leverdi të ishte i gjallë se sa të thyente qafën qoftë edhe si kampion. Jo, mor byrazer. Njëqind herë më mirë me hanxhar në dorë. Të keqen e hanxharit. E kush bëhet burri të të afrohet kur ke hanxharin në duar?


Por maqina s'para kish. Kasapit iu desh të presë shumë. Aty nga darka erdhi një kamioçinë. Kasapi i zuri rrugën. Shoferi mezi e ndali maqinën duke sharë e mallëkuar vënçe për këtë sjellje.

Kasapi u hodh në karroceri si të ish pendë. Por shoferi i donte paret në dorë. Në këto e sipër, mbërritën atje shokët e ekipit të tij që s'kishin lënë vend pa e kërkuar. Ata blokuau kamioçinën dhe, ca me të lutura ca me të shara, e morën para duarsh kandidatin për kampion, që u lutej në emër të të gjithë shënjtorëve ta linin të kthehej i gjallë pranë kalamajve.

— Amani, more vëllezër, vinin dorën në zemër! Kam tre ciliminj. Një djalë dhe tri çupa. T'ju vijë keq për mua. Ai do të më marrë shpirtin.

Por më kot, se shokët nuk e vunë dorën në zemër.

Të nesërmen salsa ish plot e përplot. Zakinisht peshat e rënda tërheqin më shumë tifozë, ashtu siç zënë edhe më tepër vëllim në hapësirë. Sapo i thirrën emrin, Ismaili doli në ring i qeshur, sikur ta kishin thirrur atje që t'i rruante mjekrën dikujt. Vetëm veshja e tij nuk i ngjante asaj të berberit. Të mbathurat i vareshin deri në kupën e gjurit, duke ja shtuar më tepër elegancën. Të



dukej çudi se si ato dy këmbë të holla mbanin me sukses atë alamet barku, që i hapej rrathë-rrathë. Po ashtu krahët e hollë, si petësa, nuk shkonin fare me atë qafë të ngjallur, e cila ngjante si një stomak i dytë. Salla po duartrokiste.

U thirr dhe emri i partnerit, por ai po vonohej. Ismaili nuk e prishi gjakun.

Kundërshtari nuk dukej gjëkundi. Salla u ngrit më këmbë nga të thirrurat. Por kasapi nuk donte të bëhej i gjallë.

Përfundimisht ai nuk foli fare në ring.

Kështu «kampioni i Australisë» u shpall kampion i Shqipërisë, vetëm pse mori mundimin të dilte në ring me kostum sportiv.

TË PUTHURAT E SHEFIKUT

Kisha marrë dy biletat basketbolli dhe po nxitoja për në ndeshje. Rrugës prisja të takojta Bar-dhin, kur, në vend të tij, më doli përpëra Shefiku, moshatar, koleg dhe bashkëfshatar.

— Po, po. Do t'ja rregulloj unë asaj — tha tërë inat.

Megjithëse unë nuk e dija se kujt do t'ja rregullonte kështu Shefiku, prapëseprapë s'e prisha gjakun, meqë dikur ai kish punuar si mekanik, pramundej që edhe tanë hera-herës t'i zinte dora diçka.

— Si je, mor shoku Shefik, dhe kujt ke ndër mend t'ja rregullosh kështu? — e pyeta.

— Asaj qafires — tha duke gulçuar.

Meqë përveç të «rregulluarit» tanë u shtue edhe një «qafire», ekuacioni u bë kështu me dy të panjohura. Unë u ngatërrrova akoma më keq, prandaj e pyeta.

— Ke ndër mend të rregullosh një qafire apo jo? Nuk e ke keq. Por, sidoqoftë, në këtë moshë... me këto punë... Mos nuk të del mirë. Ki mendjen, vëllaçko.

Ndofta nuk bëra mirë që i fola kaq pa tekli, por unë e kam shok të vjetër dhe prandaj nuk desha të rezervoheshë.

— Ç'po flet kështu, more? — ma ktheu Shefiku. — Mos folë me vete.

— Unë nuk po flas me vete. Përkundrazi m'u duk sikur ti po flisje me vete.

— Ashtu, ë? Po, mbasë u katandisa të flas me vete. Ç't'i bëj unë asaj qafires!

— Prapë me qafiren ti? Hiq dorë, more, se nuk të ka lezet.

— Kush s'më ka lezet? — pyeti Shefiku duke mbajtur hapat.

— Ajo, pra, — ja ktheva unë i kapur në befasi.

— Eh, ku të rrëh ty, mor vëlla. Unë e kam fjalën tek ime bijë, Tina.

— Pse, si është puna?

— Si mos goftë për të thënë! Ke parë kështu ti? Tetëmbëdhjetë vjeçë dhe të merret me sport! Në vend që të ishte te burri dhe të rriste kalamaj, vete e luan basketball.

— Po ku ka gjë më të mirë, o Shefik, se sa të merresh me sport në moshën më të bukur? Po a ka ushqim më të mirë për trupin se sa sporti?

— Të lutem pusho, byrazer. Ti ecën kaluar. Kur të bësh ndonjë vajzë, do të të shohim.

— Pse, ata që bëjnë vajza mos ecin më këmbë? — e pyeta me shpoti, mbasi e kisha të qartë, se ai të keqen e shikonte te sporti dhe jo te vajzat.

Shefiku u ndal, ndezi një cigare dhe më tha:

— Dëgjo, vëllaçko. Nuk është mirë të tallesh.

me hallet e botës. Nesër edhe ty mund të të trokasë kjo e keqe.

— Po ç'e keqe të gjeti, mor Shefik, pse luan çupa basketball.

— Si more ç'e keqe? Të dalë vajza cullak në moshën e martesës, mos qenka hyner sipas teje? Në këtë moshë dikur mbulonin edhe fytyrën shqet e saj. Sidoqoftë, fanatik nuk jam, ama edhe kjo s'vete. Ka kufi çdo gjë! Gjella me kripë, kripa me karar. Të luanin me tuta, hajde dreq se më ndryshe, po kështu, vëllaçko, nuk mund ta lejoj.

— A i ke qejf ndeshjet e basketbollit? — e pyeta.

— Vetëm emrin u kam dëgjuar. Përveç futbollit nuk më pëlqen tjetër sport. Në futboll po, aty ka lojë burrash. Basketbolli lanet qoftë. Sido-mos pér femrat. Sport femrash. Sa bukur e kanë gjetur! Fare pa tuta. Si në plazh.

— Po a e di ti, Shefik, se basketboli është një lojë tepër energjike, me sulme e kundërsulme, me zbritje e kundërbritje, me gjuajtje dhe me mbrojtje?

— Të jetë si të dojë, mor vëlla, veç ime bijë nuk bën të ngatërrohet në këtë muhabet. Ajo ka punë të tjera. Ja tregoj unë sportin asaj.

— Po dale, more Shefik, ta marrim shtruar...

Kështu, nisa t'i shpjegoj krejt basketballin, si në Ballkan ashtu edhe në Evropë. Por megjithëtë nuk ja mbusha që nuk ja mbusha mendjen. E bija nuk mund të luante pa tuta. Ballkani dhe Evropa të bënин si të donin. Ata kishin punët e tyre.

— Sidoqoftë çupat nuk duhet të dalin cullak!

Po t e qe me tuta, ndryshonte puna — nguli k mb  Shefiku.

— Po  eleganc  do kish nj  loj  me tuta? — e pyeta.

—  far  elegance, more! Eleganc  me  upat e bot s? Sa bukur! Mos k rkon t  tregohesh k shtu m  p rparimtar nga un ? Sikur un  nuk marr vesh fare nga bota!

— Nuk e kisha aty fjal n.

— Kije ku t  duash, mendja ime nuk mbu-
shet kollaj. Se ajo nu   sht   anak p r dhall .

Fjal  pas fjale arrit m te pallati sportiv. Un  q ndrova t  pres Bardhin, nd rsa Shefiku b ri t  hyj . Por e ndali kontrolli.

— Bilet n, shoku qytetar!

—  bilet , more? Un  jam babai i Eglantin s.

— Mos u tallni, qytetar. Babai i Eglantin s do kish bilet  n  radh n e par  ose t  dyt .

— Mua aq m  b n p r radh n e par  apo t  dyt  — ja ktheu me inat Shefiku, — un  kam ardhur t  marr Tin n se nu  e lejoj t  luaj  basketball, merr vesh apo jo?

— Tani na mbushe mendjen — tha i qet  kon-
trollori. — Kam ardhur t  marr Tin n — thot  —,
sikur e ka n   erdhe. Jo, byrazer, gjetk  i shit ato
dhe hap rrug n se do t  kalojn  njer zit.

— Si, more, po m  ndalon t  shoh time bij ?
Po me  t  drejt ?

— Se k tu  sht  pallat sporti dhe jo vend
takimesh familjare.

— Po kjo  sht  t  vesh duart n  kok !

— Vuri, kush t  mban.

Po Shefiku edhe pse s po e mbante njeri,

nuk i vuri duart në kokë. Bardhi u vonua dhe unë i dhashë njérën biletë babait të revoltuar. Gjetëm radhët tona dhe u ulëm.

Ekipe dolën për të bërë nxemjen. Asnjë lojtare nuk i kish hëqur ende tutat. Sapo dalloi të bijën, Shefiku u ngrit më këmbë dhe i tha:

— Dëgjo, Tina. Po qe se luan me tuta, luaj, ndryshe mos dil në fushë.

Në çast shkalla jonë u shkund nga të qeshurat.

— Paska qenë djall i vetë, ky mustaqja — tha një i ri aty pranë.

Unë fillova t'i shpjegoj Shefikut rregullat e mirësjelljes midis tifozëve gjatë takimeve sportive si dhe pasojat e kësaj mirësjelljeje. Por atij nuk i mbushej mendja. Sytë nuk ja ndante së bijës.

Fusha e zbraz dhe pas pak ekipet dolën për të filluar ndeshjen, natyrisht jo me tuta, siç kish urdhëruar Shefiku, por si përhera. Kjo gjë jo vettëm që nuk i pëlqeu fare Shefikut, por bile nuk iu durua pa më thënë:

— Po më turpëroi, mor vëlla.

Filloi loja. Në të dy minutat e para nuk u bë ndonjë kosh. Publiku nisi të mërzitet, sidomos Shefiku, i cili qëndronte ashtu siç mund të rrish mbi një bicikletë pa shalë.

— Sidoqoftë, mbathjet duhej t'i kishin më të gjata — tha më tepër me vete, se sa me mua.

— Mor shoku Shefik, po këtu njerëzit vijnë të shohin lojën, a më kuption? Tamam si në futboll. Pse atje ty nuk të bie ndër mend për mbathjet.

— E, de; po atje është futboll, ama.

— Atje futboll këtu basketboll. Tifozët janë po ata.

— Po janë femra, mor byrazer, janë çupa. Nuk i shikon? Të gjitha në moshë martese.

— Në moshë martese, thotë! Pse nuk thua të martuara?

— Si? Pse, paska këtu të martuara?

— E pse çuditesh?

— Si, more, të mos çuditem? Po burrat e tyre ç'thonë?

Nuk pata kohë t'i përgjigjем Shefikut, se në çast më rrëmbeu një zbritje e rrufeshme e ekipit të Tinës.

— Eh, mor byrazer, — ja filloj ai prapë — kjo lojë nuk është përfshirë femra. Ato kanë turp. Shikoji si janë skuqur.


Në çast u shënuan dy kosha radhas dhe loja u nxeh pa pritur.

Eglantina kapi një top në qendër të fushës, kaloi si ngjalë midis dy kundërshtareve dhe shënoi kosh. Spektatorët shpërthyen në duartrokitje dhe brohorima.

Ndjeva një pincë, që më kish mbërthyer brinjën e fundit, e cila, përfshirë shkakat e elasticitetit të madh, nuk po kërciste. Vura dorën aty instiki-visth dhe xhvendosa dorën e Shefikut. Pastaj ai më rrahu shpatullat, më rroku përfshirë qafe dhe, më në fund, më shkundi mirë e mirë nga jaka e palltos.

Po e shikoja me habi, mbasi këto nuk m'u dukën shenja të mira përfshirë një njeri normal.

Veçse shënjave unë s'para u zë besë. Shpesh ato të gabojnë. Ndërsa nuk gaboj po të them se miku im kish nisur të sillej me gjallëri ndaj lojës



20042
~~50578~~

së bukur dhe shkathësisë së Tinës. Natyrisht, këtu kishim të bënë me një sjellje të veçantë, origjinalë, siç i thonë, prandaj dhe unë e pashë të udhës të mos e ndërprisja me ndonjë fjalë pa vend shpërthimin e këtij origjinaliteti.

— Ashtu de, ja, kjo është lojë burrash — po fliste, për çudinë time, Shefiku, të cilin tani nuk po e mbante vendi.

Pas pak Tina shënoi sérish. Ndjeva në faqe një puthje të fortë dhe të zgjatur nga një buzë e ashpër. U drodha nga befasia. Ishte Shefiku që s'përmabahej.

— Kjo është lojë burrash, more vëlla. Të kisha thënë unë. Do fitojmë që ç'ke me të. Prit kur të gjuajmë dhe ndonjë penallti.

— Jo penallti, por personale — e korrigjova unë.

— C'është ajo personale, mor tutkun! Personales i vdiq nëna. Ne punojmë për kolektivin. Një për të gjithë dhe të gjithë pér një... Bravo, Tina, — shpërtheu gjakndezur Shefiku, duke më përfshirë me ato krahët e tij viganë. Sérish duartrokitje. Skuadra e Eglantinës ish në avantazh. Vetë ajo luante si asnijéherë.

Shefiku e gërrici gurmazin, ai brohoriste, cirrej, bërtiste, vërvhellente dhe rrihte shuplakat më keq se në stadium. Unë mendohesha, në ky djall Shefiku, gjatë rrugës, qe tallur me mua, apo si i kish punët. Mos më bëri lolo me atë qëndrim gjoja fanatic? Dhe unë i hëngra, thua?

Sérish kosh, brohorima, duartrokitje dhe pastaj një puthje nga Shefiku.

— Xhaxho, këtu ndalohen të puthurat —

dëgjuam një zë nga prapa. Shefiku u kthye tërë inat, por nuk u muar vesh se kush foli.

— Çfarë mileti! Nuk shikojnë lojën, por shikojnë se kush puthet.

Sa mbaroi ndeshja, Shefiku fluturoi poshtë shkallëve. Shtyu tej kontrollorin, që po e ndalte të hynte në fushë dhe u fut brenda.

Aty përfshiu qafas të bijën dhe e mbuloi me të puthura, duke ngatërruar kështu fotoreporterin, i cili donte ta nxirrte heroinën e ditës qcftë dhe duke e puthur i ati kaq me zjarr.

GLADIATORI I MUNDUR

Dihet se në botë tashmë njihen mjaft shkolla futbolli. Edhe ne kemi bërë diçka në këtë fushë. Unë nuk kam ndër mend të përcaktoj tiparet kryesore të kësaj shkolle, por do të flas vetëm mbi një temë.

Pavarësisht se nuk jam marrë me studime teorike, prapëseprapë nuk kam se si të mos revoltohem kur dëgjoj zëra që thonë pak a shumë këto: «futbolli nuk ka të bëjë fare me atletikën», «futbolli është aq larg nga atletika sa Shami dhe Bagdati» e të tjera.

Kështu thonë ata, të cilët nuk janë marrë ndonjëherë as me atletikën dhe as me futbollin.

Unë tanë jam atlet. Dhe ju ndoshta do të habiteni pak, kur të mësoni se karrierën sportive e kam nisur si futbollist. E tillë ështëjeta.

Ja si ndodhi kjo...

Është e tepërt të them se pasioni për futbollin më lindi qysh në fëmijëri. Unë luaja në sulm, si në krahun e majtë, ashtu edhe në të djathtin,

apo në qendër. Po ta donte puna, unë mund të kthehesha në mbrojtje e, bile, edhe si portier nuk isha i keq.

Ne atëhere luanim futboll tërë ditën, deri sa topi nuk dukej fare nga errësira e natës. Ndesjet zakonisht i përfundonim me rezultate të jashtëzakonshme për futbollin, si: 35-47, ose 78-83 etj.

Megjithëse ne nuk ndiqnim asnjë nga shkollat botërore të futbollit, rezultatet e ndeshjeve tonë ishin shumë më të larta se sa ato të takimeve ndërkomëtare në vende të ndryshme të globit.

Unë po përpaloja më mirë në futboll se sa në mësimë, gjë që në shtëpi nuk pritej me përkëdhelje.

Në moshën 16 vjeç vendosa të provoj veten. Trokita në dyert e klubit sportiv. Më priten me entuziazëm, Sidomos, kur morën vesh se unë luaja futboll, ata shpërthyen në brohoritje. Atë kohë skuadra e futbollit e qytetit tim nuk i kish mirë punët dhe rrezikohej të binte në kategorinë e dytë.

Pritja e tyre më dha krahë. Atje qe dhe trajnieri i futbollit. Aq më mirë. Që atë pasdite trajnieri më njoihu me ekipin. Kur i pashë nga afër që të gjithë, m'u dukën burra të mirë e të pjekur, sidomos trainieri. Tip babaxhani. Vërtet disave u kishin rënë pak flokët, por kjo më gëzoi akoma më tepër, mbasi në shtëpi kisha dëgjuar se njerëzit me moshë të thyer duhen dashur dhe duhen nderuar më tepër.

Ata të duan, të edukojnë dhe të mbajnë afër. Kështu ndodhi me të vërtetë. Sapo u zhvesha, më erdhi pranë një burrë rrëth të dyzetave dhe më tha:

— Ke trup tē bukur. Trup futbollisti. Do bë-hesh i mirë. Do na nderosh. Eh, tē kisha dhe një-herë moshën tënde!

Mua më erdhi aq keq për tē, saqë isha gati t'ja jepja edhe një herë atë moshë, po nuk e merr-ja dot me mend se si mund tē bëhej një gjë e tillë. Ta pyesja, nuk guxoja, mbasi, si njeri i drojtur, unë nuk pyesja, duke u përpjekur t'i mësoja vetë gjërat. Ai vijoi:

— Veç mos harro se këtu duhet vullnet i fortë. Eh, ta dish ti se ç'kemi hequr ne! Sa kemi sakrifikuar, dhe sa shumë e kemi dashur këtë xhind futbolli! Prandaj dhe nuk ndahemi dot me tē. Eh, futboll, futboll! — përfundoi duke pshérëtitur disa herë.

— Përse nuk shkruani diçka mbi futbollin — e pyeta me dashamirësi. — Fjala vjen, sa interesant do ishte për ne amatorët një libër i tillë: «Kujtimet e një futbollisti».

— Këtë do ta bëj kur tē dal në pension.

— Pse, ende s'kini dalë në pension? — pyeta unë me nxitim, por aty për aty e pashë që e shkëlla dhe nduka gjuhën. Unë gjithnjë e kam këtë dreq zakoni. Nxitoj dhe vonohem aty ku nuk duhet.

Përse ngjet kështu? Hajde gjeje...

U dëgjua bilbili i trainierit. Sakaq skuadra u nda në dy grupe. Do kish ndeshje. Unë sa s'fluturoja nga gëzimi. Do luaja me tē rriturit. Me cilin grup do caktokesha? Dy veta po më tërhiqnin nga krahët, kuptohet, secili për hesap tē vet. Por trainieri nuk i la tē grindeshin.

— Këtë ma lini mua, — tha ai qetë-qetë. Nuk thonë kot se, kur grinden dy veta, përfiton i tre-

ti. Por çdo bëja unë me trainierin? Mos do të më caktonte arbitër? Kjo nuk më pëlqente. Sapo filloj loja, trainieri më kapi nga dora dhe dolëm nga fusha.

Më kot përpinqesha të merrja me mend se ku do të më conte.

— Mos u ngut — më tha. — Futbollisti kurrë nuk duhet ta nisë drejt me topin periudhën pre-gatitore të stërvitjes. Kjo do kish pasoja të koshme. Ti ke nevojë për pregatitje fizike intensive. Pra nisu dhe bjeri katër herë rrëth fushës.

U nisa pothuaj duke kërcyer. E ç'janë për mua katër xhiro! Pastaj, bam me top, Por gabova. Sapo iu paraqita trainerit, ai më tha ftohtë.

— Nisu prapë. Edhe gjashtë xhiro të tjera. — Unë sërisht u nisa, por jo më duke kërcyer. Sidofoftë ndonjë gjë e madhe për fizikun tim nuk qe.

Pas pesëmbëdhjetë minutash, si rregullova frymëmarrjen, shkova dhe i raportova trainerit se isha gati të luaja futboll **me shokët**.

— Mos u ngut — më tha ai dhe më kapi së-rish nga dora. Dolëm jashtë stadiumit. Traineri mori edhe bicikletën e tij. Me sa dukej, do të ma jepte të bëja kros çiklistik. Trainieri, pa u ngutur i hipi bicikletës dhe më tha:

— Tre xhiro rrëth stadiumit.

U nisa buzëvarur. Por bicikleta ecte më mirë.

— Më shpejt, më shpejt — urdhëroi traineri. Dhe unë, duke kujtuar vullnetet e forta, u dhashë më shpejt këmbëve

Pas xhiros së dytë, traineri urdhëroi: — Më shpejt, Elmaz. Duhet të më arrish. — Unë u preka në sedër dhe, meqë e kisha xhiron e fundit, i bëra një sprind trainerit mbi bicikletë.

Në fund të xhiros së tretë ngadalësova shpejtësinë pak nga pak dhe po rregulloja frysëmarrjen, kur trainieri më tha me gjakftohtësi.

— Mos u ngut, ke dhe katër xhiro.

— A dini çfarë, shoku trainier — guxova të flas unë.

— Urdhëro!

— Ju më mirë caktomëni qysh në fillim sa xhiro do të bëj. Përse të m'i jepni kështu pjesë-pjesë.

— Atë e di unë. Këto janë çështje takti. Të mos dekurajohesh.

— Bah, unë kam vullnet të fortë.

— Ashtu qoftë, por kjo do verifikuar.

Dhe trainieri, për të verifikuar këtë, më ndiqte nga pas me biçikletë, duke më dhënë këshillat dhe urdhërat e rastit mbi taktin e hapit.

Kuptohet se ai më udhëzont^a shala e bicikletës. Ju e merrni me mend pra, se ai fliste kaluar.

Kur trainieri më tha se duhej të bëja dhe shtatë xhiro të tjera rrëth stadiumit, për të mbyllur grafikun ditor të vrapimit, mua nuk më erdhi dhe aq mirë.

— Po pas këtyre dhe sa xhiro të tjera do më duhet të bëj? — e pyeta me singjeritet.

— Asnjë hap më tepër. Dhe tani nisu! — U nisa. Kur përfundova, zemra më trokiste, si vare farkëtarie.

Trainieri më mori nga dora dhe u futëm në palestrën e gjimnastikës.

Pa pritur të merrja veten, urdhëroi:

— Njëzet xhiro rrëth sallës. Këto i kisha si bukë me gjalpjë në krahasim me ato rrëth stadiumin, ndaj u nisa tërë gaz.

Pas atyre bëra edhe tridhjetë e pesë e pastaj edhe dyzet të tjera.

Mendtë kishin filluar të më merreshin, gjë që nuk më kish ndodhur deri atëhere. Sapo mbarova xhirot, trainieri më prezantoi me shkallën suedeze. Më urdhëroi të bëja dyzet pompa dhe dyzet skuadra. Pas kësaj ky numër u dyfishua. Prej andej më coi në paralele. Pastaj me radhë kaluam kalin, kaluçin, u ndalëm edhe të hekuri, pastaj në traun e ekuilibrit. Si mbarova ushtrimet e ekuilibrit, iu ngjita litarit, tërhoqa sustat dhe dinamometrin. Më vonë kërceva së gjati, së larti me shkop e pa shkop dhe mbylljen e bëra me pedanën e ngritjes së peshave. Meqë ish errur e nuk dukej mirë, trainieri ndezi dritat e palestrës. Si i vuri shtangës pesëdhjetë kilogram, më tha miqësish:

— Ulje-ngritje pesë herë nga dhjetë. Pastaj ja nisëm nga e para. Nuk thonë kot se përsëritja është nëna e dijes. Por se ç'është përsëritja e përsëritjes, këtë s'e kanë thënë akoma.

Ushtrimet u përsëritën me gjashtëdhjetë kilogram, më pas me shtatëdhjetë kilogram dhe s'dihej deri ku do vazhdonim, sikur unë të mund të ngrija dot më tepër. Por unë nuk mundja më, me gjithë vullnetin tim të mirë e të fortë.

Pas kësaj trainieri po mendonte se ç'mund të bënte akoma me mua. Si e pashë aq të sëkëlldisur, desha me gjith qejf t'i vija në ndihmë, por, si e qysh, s'më shkrepte asnë ide, mbasi i kisha bërë të gjitha llojet e ushtrimeve që më kish zënë veshi.

— Marsh te shkalla suedeze — më tha ai me buzë në gaz, duke më shoqëruar vetë me dorë në sup.

— Shtatëdhjetë pompa dhe shtatëdhjetë skuadra.

— Po pas këtyre ka më?

— Jo!

Fillova gjithë gaz, duke menduar se po i vinte fundi provës së madhe. Por e ndjeja se isha lodhur më shumë nga ç'meritoja. Për të mos vënë në dyshim vullnetin tim të fortë, vazhdova me shpirt në dhëmbë deri sa e përfundova.

Trainieri sérish filloi të vrasë medjen, se çdo bënte me mua.

— Tani do bëjmë një ndeshje skerme — tha dhe u largua shumë i gëzuar për këtë pjellori të mendjes së tij.

Pas pak u kthye me dy rapjera dhe me pajimet e tjera të skermës. Sakaq m'u kujtua Žhan Mareja me Xherar Filipin dhe më erdhi keq që nuk u ndodh aty në palestër ndonjë shok nga të kinostudios.

Unë skermë edhe kisha parë, po për të luajtur, nuk më kish rënë rasti, me përjashtim të lojrave fëminore. Kështu trainieri nuk e pati të vështirë të më vërë përpara.

Megjithëse isha i këputur fizikisht, luaja me gjithë qejf, meqë skerma më tërhiqte. Skerma ka diçka me të vërtetë të bukur në vetëvete, mbasi aty të duket vetja si fëmijë i rritur.

Isha lodhur aq shumë sa më dukej se s'isha unë ai që po tërhiqesha vazhdimisht përpara sulmit të pamëshirshëm të trainierit.



Mua më dukej se isha shtrirë diku në një dy-shek dhe po gërhisja.

Në këto e sipër një majë metalike më preku syprinën e këpucës. U këputa e rashë në dysheme si një gladiator i mundur. Nuk munda të çohem. Por as që e déshiroja një gjë të tillë. Trainieri u alarmua. Provoi të më merrte përpara biçikletës, por unë nuk qëndroja dot. Pas pak mbërriti në vendin e ngjarjes një taksi. Doktor Metua më dhanëndihmën e parë dhe pastaj me autoambulancë më nisën për në shtëpi.

Fjeta pa vënë gjë në gojë. Në kondita të tjerë, kjo do të qe e pamundur. Pas dyzet e gjashtë orësh u zgjova nga gjumi i rëndë e plot èndrra të llahtarshme: më bëhej sikur trainieri më urdhëronte të bëja me vrap tridhjetë e gjashtë xhiro rrëth tokës; pas kësaj më urdhëronte të bëja edhe dyzet e pesë të tjera, e më vonë edhe shtatëdhjetë e katër të tjera. Unë isha bërë erë e raketë, djalli e merrte vesh. Si mbarova këto, trainieri më urdhëroi të përshkoja me vrap distancat: Tokë — Venus — Mars — Jupiter — Sirius — Tokë!

Por sapo kalova Venusin, më doli gjumi, kështu që planetet e tjera mbetën për radhën tjetër. Provova të çohem. E pamundur! Një gjë e tillë qënkej jashtë vullnetit tim të fortë. Më dhimbte i gjithë trupi, të gjitha qelizat një për një. Më dukej sikur ma kishin mbushur shtatin me gjilpëra në çdo por. Kjo gjëndje vijoi për dy ditë. Ditën e tretë munda të pi pak qumësht të zier.

Doktor Metua erdhi sërisht me një komision mjekësor. Po ashtu edhe trainieri nuk më harroi.

Vetëm se, me sa kuptova unë, atij i vinte keq që nuk mund të më urdhëronte të bëja disa xhiro me vrap brenda ose jashtë dhomës.

Si e mora veten, isha në mëdyshje për punën e futbollit. Të shkoja apo të mos shkoja, kjo qe çështja. Më kujtohej vrapimi im i pafund në galaktikë, si dhe ngritja e peshave. Këto më pëlqenin më shumë.

Vrapimi më qe bërë natyrë e dytë. Dhe këtu, në shtëpi, nga tryeza në kontrabufe, shkoja e kthehesha me vrap, gjë që merrej për shaka.

Për të mos lejuar që vullneti im i fortë të humbiste kot, unë i vajta prapë trainierit.

Ekipi ishte po ai. Po ata bablokë me flokët gjysmë të rënë: simbol i urtësisë dhe i zguarsisë. Asnjë i ri në ekip, përveç meje, që ende nuk kisha fituar të drejtën për të prekur topin me këmbë.

Nxemja sapo kish filluar. M'u afrua trainieri.


— Mos u ngut, — tha ai. — Katër xhiro rreth fushës.

— Vetëm kaq?

— Pastaj shohim e bëjmë. Dhe historia e ditës së parë u përsërit me besnikëri. Fundi i fundit vullnetet e forta nuk janë vetëm koncepte apo nocione, por duhet të ketë diçka edhe nga praktika.

Si mbusha pesë muaj me vrapime të tillë, me gjimnastikë, skermë, ngritje peshash e të tjera, unë me keqardhje e braktisa trainierin tim.

Një javë më vonë në qytetin tonë u hap spartakiada e qendrave të punës. Që atëhere ngjarjet rrodhën me shpejtësinë e vrapimeve të mia.



Unë theva dy rekorde të rinjsh në vrapimet e gjata dhe një rekord kombëtar në ngritje peshash. Profili im si sportist u vendos në mënyrë përfundimtare.

Dhe këto radhë i shkrojta vetëm për të tre-guar lidhjet kauzale midis futbollit dhe atletikës.

GOLI IM I VETËM

Kam plot shtatëmbëdhjetë vjet që luaj futball dhe gjithmonë si sulmonjës i majtë. Unë sulmoj rrufeshëm, kaloj me top e pa top, shfrytëzoj korridoret, kthesat dhe labirintet, tribloj me elegancë dhe gjuaj nga çdo largësi me këmbë e me kokë.

Kam vetëm një të metë, të cilën ende nuk po e ndreq dot. Unë nuk mundem të shënoj gola. Nuk e kuptoj nga se vjen kjo fatkeqësi, por ja që unë edhe pse për çdo gjë nuk ma ha qeni shkopin, gola s'mund të shënoj dot. Mendoj se kjo është një çështje shorti. Të thuash se tronditem, kjo nuk është e vërtetë.

Pra shkaku duhet kërkuar gjetkë. Ndoshta në drejtimin e erës, në ndryshimet e temperaturës, në nivelin e ujërave apo në shpejtësinë e rrotullimit të tokës.

Veçse, kudo që të qëndrojë shkaku, pasoja është po ajo: unë nuk mundem të shënoj gol!

Në këtë mes nuk mund të nxjerr të lara nga çdo faj edhe portat e futbollit. Ato, sipas meje,

janë tepër të vogla, janë aq të vogla, saqë më lehtë mund të kalojë deveja në vrimën e gjilpërës se sa topi i futbollit në katërkëndshin e portës.

Po ashtu, për mendimin tim, përgjegjësi duhet të mbajnë edhe portierët, mbasi edhe ato pak gjuajtje që unë kam bërë në portë, ata i kanë kapur, pa pasur fare parasysh normat e respektit dhe të mirësjelljes.

Dhe unë vijoj të mos shënoj gola. Kjo gjendje më shqetëson si mua edhe ekipin. Më në fund, çështja ime u shtrua në analizën vjetore. Të gjithë shokët më kritikuan. Të gjithë! Dhe mua më dukej se kishin arësy. Unë nuk kisha shënuar asnjë gol... Asnjë! Çudi, pra, asnjë gol! Po përsë? Përsë të mos shënoja asnjë gol?

Kjo pyetje tanë donte përgjegje. Po ç'mund të përgjigjesha unë? E, megjithatë, kish ardhur koha për një përgjegje serioze.

Si e pashë se nuk kisha nga t'ja mbaja, ungrita.

— Po shokë! Çështja është tepër serioze dhe unë e kuptoj mirë këtë gjë. Pyetja është e qartë: përsë unë nuk shënoj gol? Përsë, pra?

As unë nuk e di! Por, të mos e dish një gjë, kjo nuk të përjashton aspak nga përgjegjësia e plotë. Pra edhe unë nuk duhet të përjashtohem nga përgjegjësia e plotë. Në këtë mënyrë, për të vënë në vend gabimet e së kaluarës dhe për të dalë fajebardhë në të ardhmen, marr zotim se që në ndeshjen e parë do të shënoj gol. Do të jetë goli im i parë, gjëzimi më i madh i jetës sime!

Unë do ta arrij këtë në saje të ndihmës suaj dhe të një pune më këmbëngulëse e më serioze

nga ana ime. Do punoj me sinqeritet për ngritjen time profesionale. Unë jam i sinqertë dhe ju ma besoni këtë.

Edhe literaturë teknike do të lexoj më tepër. Do të studjoj me vëmendje jo vetëm faqen e kronikave të futbollit në «Sportin Popullor», por do të dëgjoj edhe rubrikën sportive nga radiua, që transmetohet çdo të diel në orën 21, gjithashtu do dëgjoj me vëmendje këtej e tutje edhe vërejtjet apo sugjerimet e tifozëve. Kështu shpresoj se do ta ngre disi cilësinë e gjuajtjeve të mia në portë, aq sa të paktën të shënoj një gol.

U ula në mes të breshërisë së duartrokitjeve, gjë që më ngriti moralin dyfish.

* * *

U përpoqa që zotimin ta përbush me ndërfill pas mbledhjes shkova në bibliotekë dhe mora që aty koleksionin e dy viteve të fundit të «Sportit Popullor». Po me këtë seriozitet shkova katalogun e botimeve, duke hequr mënjanë çdo artikull mbi futbollin. Edhe në bisedat me shokët apo me farefisin, me marifet e bija fjalën te futbolli vetëm për të dëgjuar mendimet e tyre. Një ditë bile i telefonova dhe Zigurit në Përmet. Kisha gjashtë vjet pa u takuar me të dhe tani më interesonte të dija ç'kish menduar ai gjatë këtyre viteve për futbollin.

Në një bisedë me shefin e kuadrit mbi normat kolektive, unë e pyeta papritur:

— Sa veta bëheni ju në familje?

— Tetë — u përgjegj ai i hutuar. — Po nuk di ç'ka të bëjë kjo me çështjen që diskutoj.

— Jo po unë desha të di se ç'mendojnë njerëzit tuaj pér futbollin. Fjala vjen, si mund ta bëjmë sa më interesante këtë lojë, si ta modernizojmë, ta përsosim, si mund të futim sa më shumë gola.

Për çudi, shefi buzëqeshi, shkundi cigaren dhe tha:

— Nuk është mirë të futim shakara në mes të diskutimeve serioze.

Pas dy javësh, kishim një ndeshje miqësore. Unë dola në fushë i sigurt dhe i vendosur pér të shënuar gol! Kjo gjë nuk kish se si të mos ndodhte, nuk mund të shmangej.

Filloi loja. Si mora një top nga mbrojtja, fluturova përmes fushës dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, u gjenda në zonën e rreptësisë. Atje kalova dy mbrojtës dhe po sorollatja të tretin, kur më doli përpara portieri. Parabël — mendova me vete; gjuajta. Por, meqë koordinata ish llogaritur gabim, trajktorja kapërceu shumë në lartësi shtyllën horizontale të portës.

Unë kapa kokën me duar, se mendova që një rast i tillë nuk do përsëritez më. Aty më erdhi një nga shokët e mi.

— U vrave, Hysko?

— Jo, falemnderit!

— Mirë! Për golin mos u bëj merak. Gjuaj pa frikë nga larg, mbasi portierit ja kemi sqaruar hallin tënd dhe ai është i mendimit që ti të mos diskretitohesh. Pra gjuaj, Hysko, more vesh?

— Mora, falemnderit. Dhe me tē vërtetë kisha marrë vesh diçka, por ja që nuk më ecte.

«Sidoqoftë, — mendova me vete — meqë portieri është i mendimit që unë tē bëj gol, me portën do bëj si do bëj, po golin do ta shënoj.

Shokët pothuaj tē gjitha pasat m'i jepnin mua. Unë s'dija si t'i falnderoja pér këto shërbime, por ama topi s'donte që s'donte tē futej në portë. Më në fund, në minutën e tridhjetë e shtatë u ndodha vetëm pér vetëm me portierin. Ai u hutua dhe më ktheu krahët. Por kjo gjë më hutoi edhe mua akoma më keq. Gjuajta një bombë, por topi, si preku shpatullat e portierit, doli jashtë.

Po pse, pra, ky djall portieri nuk u ul galic, — se kështu topi do shkonte drejt e në rrjetë, — duke më nxjerrë edhe mua faqebardhë?

U gjuajt top nga këndi. Lëmsh pérpara portës! Nuk mora vesh në atë gjullurdi se si topi erdhì vetvetiu në këmbët e mia. Porta ish pa portier. Rasti më ideal! Shut-bombë... Gol!... Jo. Jashtë! Pér hic gjë.

Vetëm tre-katër pëllëmbë në krahun e djath-të tē portës. Ah, portë, portë, sa e pabesë më dole!...

Me këtë rast m'u mbush mendja top, se unë nuk mund tē shënoja dot gol sido që tē vinte puna. Nga çdo largësi që tē gjuaja, me portier ose pa portier, gol nuk mund tē shënoja. Kjo ish e vërteta.

Duke bluajtur këto pikëpamje, mbrojtësi kundërshtar shkaktoi kotë së koti një penallti. Ky gjest më habit, mbasi ç'arësy ka tē mbërthesh topin me dorë kur nuç ke asnjë kundërshtar gjer



tridhjetë metra afër? Mos vallë edhe ky ma dinte hallin? Portieri kundërshtar, në vend që të pre-gatitej, u hoq mënjanë dhe ndezi një cigare. Mirë, pa e shikon!

Mora vrull dhe gjuajta me të gjithë forcën e këmbës. Jashtë! Në djall. Po kthehem në mbrojtje. Dhe u ktheva. Dhe do ti që aty luaja për mrekulli! Vetëm se i vrarë shpirtërisht.

Loja vijonte. Aty nga sekondat e fundit kapa një top në zonën e rreptësisë, por u gjenda i rrethuar nga via e sulmit kundërshtar. Kjo më bëri t'i vë gishtin **kokës**. **Nuk më mbetej** asnje shteg daljeje. I sigurt në vetëvete se topi i gjuajtur nga unë mund të përfundonte kudo në gjithësi, vetëm se jo brënda katorit të portës, u ktheva nga portieri im dhe gjuajta pa frikë. Dhe për habinë time shënova gol!

Gol? Me të vërtetë? Autogol! Stadiumi buçiste. E bashkë me të edhe koka ime. Kisha shënuar për të parën herë.

E ku ta dish, ndoshta edhe për të fundit herë...

RRËSHQITJE DIAGONALE

Ideja për të rrëshqitur me ski nuk ishte e re për mua. Ajo kish kohë që po më guduliste, vëtëm se nuk më kish rastisur ndonjëherë të merresha me këtë sport.

Një të shtunë pas dite ne, një grup të rinjsh nga kursi ynë u mblozhëm dhe u nisëm për në malin e Dajtit. Kish rënë dëborë e bollshme, e cila kish sajuar mjaft vende për ski.

Nga gjeografia mbaja mend se mali i Dajtit bie në lindje të vendit, se është 1612 metra i lartë, ka atë e këtë temperaturë, por me këmbë asnjëherë nuk e kisha shkelur.

Po, kur filloi ngjitja, pashë se mali i Dajtit nuk ish aq i lehtë sa në faqet e tekstit. Gjithashtu më lindën dyshime serioze edhe mbi lartësinë në metra. Duhej të qe më i lartë nga ç'thoshte teksti.

Në darkë ne u gjendëm në kampin e Dajtit. Atje bënte freskët, tepër freskët. Frymëmarrja ish e lehtë dhe ajri t'i mbushte plot e përplot mushkëritë. Këtu ish pra tjetër klimë. Ishte një

Iloj klime, e cila të bënte mjaft mirë për oreksin. Ndërsa mua, që edhe kështu nuk jam keq me të, m'u desh t'ja shtroja menjëherë. Kështu i gjithë gallami që kisha marrë me vete vajti viktimë e atij ajri të pastër e oreksdhënës.

Pas buke kënduam disa këngë dhe aty nga ora 23 ja morëm me të fjetur.

Dielli na zuri në sheshin e skive. Atje panorama qe e larmishme dhe gazmore. Disa rrëshqisnin, disa të tjerë rrëzoheshin në gjithfarë stilesh që mund t'i kishe zili.

Të tjerë pastaj ngriheshin, po prapë binin pas dy a më shumë metrash; prapë ngriheshin, por graviteti kokëfortë i tërhiqte me këmbëngulje, deri sa të ngulnin hundën në borë.

Përmes mjegullave, dielli buzëqeshte e zbavitej me amatorët e këtij sporti argëtues.

Duke i parë të gjitha këto, mua nuk më durohej deri sa të mbërtheja skitë dhe të filloja. Për çdo rast kisha marrë me vete një broshurë, ku jepeshin udhëzime të holla dhe të sakta mbi përdorimin me sukses të skive. Por mua më dukeshin gjëra të tepërtë këto udhëzime, meqë më besohej se unë kisha lindur për të fluturuar me ski.

U ngrita dhe provova të bëj tutje pa marrë vesh se cila forcë më shtyti të bie me kokë pingulthi. Njëra nga skitë më qe futur nën sqetull, mesa dukej nga të ftohit. «Aksidentalish, — mendova unë dhe u ngrita me besim e me forca të reja. Dhe prapë nuk mora vesh se si u rrëzoava fare pa rrëshqitur. Kjo gjë u përsërit aq dendur, saqë nisa të mendoj seriozisht se në sajë të

cilës force unë përplasesha në tokë sa majtas djathtas. Mos vallë përveç gravitetit ekziston edhe ndonjë tjetër forcë tërheqëse e pazbuluar deri tanë?

E pashë me vend të lexoja instruksionin mbi skitë. U ula galiç dhe nisa të lexoj. «Kryesorja është të rrëshqasësh, por të mos rrëzohesh! (Këtë e dija dhe vetë). Trupi duhet të përkulet përra para në raport të drejtë me pjerrësinë e terrenit. Gjunjët duhen thyer 25-30 gradë». Për mua këtu dilnin dy gjëra të paqarta. Si ta kuptoja raportin e pjerrësisë së terrenit me përkuljen e trupit dhe me se t'i masja gradët e thyerjes së gjunjëve... «Skitë duhen të mbahen 10-15 centimetra larg njëra-tjetrës, ndërsa duart pak të hapura anash dhe të thyera lehtë në bërryle»...

U çova duke dashur të provoj këto pozicione. Por as skitë nuk i largova dot 15 centimetra nga njëra-tjetra dhe as krahët nuk i hapa pak anash të thyera lehtë në bërryle. Ndërsa, kur u plasa përtokë, krahët i hapa krejt, duke formuar një pentagramë.

U ngrita dhe mora instruksionin. «Rregulli themelor është që trupi të jetë vertikal me pjerrësinë dhe skitë të rrëshqasin...» Po, për çudi, skitë e mia rrëshqitën vetvetiu, duke më flakur tre metra më tej së bashku me instruksionin.

Si njeri i vendosur dhe me kurajë, i bindur në vetëvete për drejtësinë e çështjes me të cilën merrem, u ngrita dhe nisa prapë të lexojë... «Në tatëpjetë duhet të aplikojmë lëvizjet diagonale me qëndrim vertikal të trupit... Trupi peshon në këmbën që qëndron më poshtë, e cila, në këtë

rast, duhet të vijë pak më mbrapa, në drejtim paralel me këmbën që qëndron më sipër, duke pasur kujdes që gjunjët të shkojnë me vendosmëri nga lartësia, në të njëjtën kohë, kur trupi, prej gollganeve e lart, automatikisht duhet anuar për tatëpjetë në mënyrë që të rrrotullohesh pak nga bregu në drejtim të spiraleve të tryelës, kështu që skitë vetveti do të ngadalësojnë shpejtësinë në bazë të teorisë së fërkimit të dy trupave lëndorë inorganikë, mbasi forca e gravitetit dihet fare mirë që të tërheq nga pjerrësia duke respektuar reciprokisht edhe ligjin e ekuilibrit në hapësirë. Kjo ndodh sidomos kur vendi është me akull ose me borë të ngrirë, gjë që i jep shkas shtimit të shpejtësisë dhe kjo, nga ana e saj, po që se nuk zotëron dot teknikën e frenimit, e mëtë kjo e gjithë fillestarëve, dhe që bie pasoia të padiskutueshme për harmoninë e gjymtyrëve dhe simetrinë anatomike të trupit»...

Meqë koka filloj të më nxehet dhe këmbët po më ftoheshin, gjë që vjen në kundërshtim me këshillat e mjekut, unë futa në xhep broshurën dhe vendosa të rrëshqas si autodidakt.

U nisa me rrëshqitje diagonale, duke dashur të përkul trupin në raport me terrenin pa menduar se kështu do fundosesha perpendikularisht ~~në borë~~. Njëra ski më dolë nga këmba dhe vazhdonte rrëshqitjen si autodidakte. Hoqa skinë tjetër dhe u nisa të zë të parën.

Por sa e arrita, skia tjetër filloj të rrëshqasë me devijim tridhjetë gradë majtas dhe mezi arri ta t'i dal përpëra.

Hipa mbi ski dhe guxova prapë t'i zbuloja të

fshehtat e atyre dy copë dërrasave paralele. Por dihet se zbulimet nuk janë fort të lehta dhe nuk janë arritur gjithmonë pa vështirësi. Rashë rë shpinë, duke përshëndetur diellin gazmor. Isha bërë ujë në djersë, por vullneti është vullnet.

Gjendja rreth e rrotull më jepte kurajë, me që kështu ngrihej edhe vetë moralisht, se po-thuaj të gjithë qenë fillestarë në këtë zanat.


Vendosa të rrëshqas horizontalisht dhe me bërryle të thyera, por një gjë e tillë fort pak varej nga unë. Këtu vendoste graviteti.

Pas pak më doli përparrë Lefteria. Unë desha të kthehem majtas, por anova djathjas, pastaj u shtrina përparrë sa gjatë gjerë, Lefteria që, me sa dukej, s'kish frenë, futi majat e skive nën brinjët e mia dhe vetë më kapërceu me një të hedhur së larti. Pastaj erdhi e më dha dorën. Skitë e saj qenë gërvishur pak, ndërsa brinjët e mia s'kishin pasur gjë.

I kërkova të falur shoqes sime dhe vijova rrugën... vijova rrugën... kjo është një fjalë goje. Me këtë rast provova vetë se rrëshqitja bar-kas ose në shpinë është më e lehtë se ajo mbi skitë.

Atëherë s'kuptoj pse na ngatërrojnë me kë-to dërrasa paralele që dreqi ua merr dorën. Kështu do dilnin të tepërtë edhe lëvizjet diagonale me gjunjë të përkulura dhe me bërryle të thyera.

Deri tani besoja se ekuacionet diferencale, sidomos diferençiali i numrit «e», qe gjëja më e vështirë! Kur ja tek del se nuk paska vështirësi më të madhe se sa mësimi i skive. Ndoshta inte-



gralet dhe diferencialet do ndihmonin disi si kë-të mes, po hajde dhe aplikoji gjithë ato formula mbi skitë.

E kuptoja se këtu fshiheshin disa sekrete, por, se ç'qenë ato dhe si zbërtheheshin, kjo ish tjetër punë.

U nisa! Përpara më doli një lis. Duhej ose të devijoja rrugën, ose të rrafshoja lisin nga faqja e dhet. Ndërkohë harrova fare se nga e kisha të majtën dhe nga të djathtën. Trungu i lisit po më afrohej me shpejtësi. Përplasja ish e pashmang-shme. Por a i bihet trungut me kokë? «Kryesorja është gjakftohtësia — mendova. — Po e ruajte gjakun e ftohtë, edhe kokën mund të mos e çash më dysh».

Dhe pak e trungu do të përmbysej. Por shpëtoi! Në çastin e kobshëm më lindi ideja humanitarë. Përpara trungut, unë u hodha përpjetë (si në kërcim së larti) dhe u kapa fort me të dy duart në degët e lisit. Kështu përfundoi mësimi im i parë në ski.

PAS NDESHJES

Diskutimi ndërmjet një grupei shokësh midis të cilëve ish edhe miku im, Astriti, nga ndeshja e asaj dite kaloi pa pritur në kibernetikë dhe në elektronikë. S'kishim arritur ende te udhëtimet ndërplanetare, kur u dha te dera Faruni, një shoku ynë i vjetër.

Faruni kudo që të vejë e këdo që të gjejë, nuk e zgjat shumë. Në fillim çakërit ca sytë e skuqur, deri sa të marrë vesh se ku është muhabeti, pastaj frap merr fjälën vetë.

— Ç'është ky Jupiter, Sirius e gorrica pikëla?
— na ulëriti neve. — Po ç'thoni ju, bre, për ndeshjen që pamë? Po a e morët vesh se ç'tha trainieri i Gallatastarait? Po arbitrin çek e dëgjuat? Jo! Po ç'bëtë ju? Jini në vete apo jo? Përse veni në stadium? Përse i digjni kot biletat e tribunës, kur të tjerët digjen vetëm për të futur kokën në stadium? Po a dini ju se ka njerëz që janë gati të nxjerrin njërin sy, vetëm që të mos mbeten pa biletë? Jo, s'e dini! Po a e dini ju se unë shqepa

këmishën silon kur ne shënuam golin e dytë? Dhe a e dini se ajo na qënkej këmisha e shokut që kisha në krah dhe se dreqi e mori vesh se si na qenë ngatërruar. U pa puna. Unë i dhashë këmishën time dhe ai, për mirësjellje, e grisi si dhe unë. Kështu dolëm një me një. Po a e dini ju se ç'tha trainieri i «Juventusit», që kish ardhur për të parë ndeshjen?

E ç'nuk foli aty i palodhuri, energjiku Farun... Po a dinim ne se ç'do shkruanin të nesërmen gazetat e Ballkanit dhe të Evropës? Po a e dinim ne, se kur ta merrte vesh këtë trainieri i Brazilit, do na ftonte për një turne atje? Po a e dinim ne se kjo qe një nga ndeshjet më të bukura të sezonit?.. Po a dinim ne, se dhe pak e mund të çmendeshim?

Kam vërejtur me keqardhje, se pak i respektojmë sot njerëzit si Faruni, që kanë cilësi të të kalisin vullnetin. Kjo është një e metë në edukatën tonë, e metë që nuk dihet sa do na kushtojë.

Pandehni se bëj shaka? Pa provojeni pak ju rolin e Farunit? Pa provoni të thoni me saktësi se kur u krijuva «Barcelona» dhe sa herë e ka rrahur «Madridin», me ç'rezultat dhe me ç'golaverazh të përgjithshëm? Po a mund të na thoni ju se sa herë e ka rrahur «Ranxhersi» «Sent Etienin» dhe sa herë ka ngrënë dru vënçe «Panathinakosi» nga Fenerbahçeja? Po a dini ju se skuadra kombëtare braziliiane po pregetitet me 230 lojtarë në një stadium nëntokësor?

E si mund ta dinim ne se atje janë zbuluar lojtarë, para të cilëve Pelja është një copë spurdhjak?

Ju nuk mund ta dini se Faruni është një en-

ciklopedi botërore e futbollit. Ju s'e dini, por ne e morëm vesh. Unë e di që kam lindur me këmishë. Por nuk ma hante mendja se këmisha ime do t'u vinte pas trupit edhe shtatë prej shokëve të mi.

Gjithashtu ne nuk e dinim se pas disa ditësh vinte 23-vjetori i lojërave ballkanike. Dhe, me siguri, përderisa nuk dinim kaq gjë, si do kish mundësi të mbanim mend rezultatet e këtyre lojërave? Kështu, Faruni e pa të arësyeshme të na i kujtonte një për një këto rezultate. Por meqë lojërat e para ballkanike nuk vazhduan shumë vjet, Faruni i mbaroi shpejt e shpejt rezultatet dhe u hodh pastaj në komentet mbi çdo takim një për një.

Mbante mend edhe minutat historike në të cilat qenë shënuar golat; po ashtu përmendte me saktësi enciklopedike dhe autorët e shënimit.

Ne po e shikonim të habitur për këtë dituri të gjerë, dhe qemë habitur aq shumë, saqë nuk morëm vesh, kur kaloi Faruni nga ballkaniada e parë në historikun e futbollit tonë. Në vijim, ai vlotësoi për barazimin e padrejtë 3:3 midis «Spartakut» të Tiranës dhe «Punës» së Fierit në vitin 1956. Po ashtu i dukej krejt i pavend barazimi i atij viti ndërmjet «Luftëtarit» të Shkollës së Bashkuar dhe Dinamos.

Pavarësisht në e ndiqnim apo jo, Faruni vijoi enciklopedinë gojore të futbollit tonë, duke mos harruar asnjë hollësi, asnjë rrëthanë interesante apo situatë kritike. Mua, së paku, më dukej se ko-ka më qe shndërruar në një top futbolli, me të cilin Faruni gjuante penallti pa mëshirë në portën e kundërshtarit.

Unë tani mund të diskutoj hapët për futbollin

me këdo nga trainerët, lojtarët, arbitrat, shkencëtarët, arkivistët, fotoreporterët e të tjerë. Unë mora vesh se ç'ka thënë, në vitin 1911, traineri i «Standardit» në Bolonjë, kur skuadra e tij fatkeqe u rrah për kupën «Rapan» në një ditë me shi si kjo e sotmja. Unë mësova se kur ka lindur Di Stefano dhe sa gola ka shënuar! Se Zagallua qenka bërë trainer e të tjera e të tjera.

Faruni është i palodhur, i pakrahasueshëm.

Po a e dini ju pse u eleminua «Kumasi Asante Kotoko?»

Të shkretin Astrit e mbërtheu keq sinuziti. Ai nuk mundi të duronte më. Unë e kuptova, po nuk kisha si t'i veja në ndihmë. Por Astriti u tregua më i zgjuar nga ç'e prisja.


Përfitoi nga një teshtimë e zgjatur e Farunit, mori lejë vetëtimthi dhe s'e pamë në e hapi derën apo doli nga vrima e çelësit.

Ajri në dhomë u rëndua. Shokët një nga një, por me stile të ndryshme, u larguan, duke më lënë vetëm dhe ballë për ballë me gjigantin Farun ose Firaun, siç i thoshnim në vegjeli.

A e dija unë pse qe ndërtuar kështu formacioni i sotëm? A e dija unë se nga ç'largësi shënoi sot Bytyçi? Po a e dija unë pse nuk luajti Bylyku N. Ah, të shkretën! Së paku për Bylykun duhej ta kisha marrë vesh!

Kështu për herë të parë në jetë kuptova se sa analfabet isha në futboll. As me shifra s'di se si ta tregoj. Ndoshta minus 170 për qind.

Bëra një kafe me shpresë se Faruni do pushonte. E pamundur. Bile harrova që kafja nxit



kujtesën. Mbushëm dhe dy konjakë. Po ajo punë. Dalngadalë zbrazëm gjithë shishen.

Nisëm një shishe të pahapur me raki rrushi, e quam në mes, e thamë me fund. Po ajo melodi. Farunit as gjuha nuk po i trashej. Unë duhej të shkoja diku për vizitë. I mora leje Farunit dhe u çova menjëherë. Oh! ai nuk u pikëllua fare. I patrembur, Faruni sa të rrallë i ka shokët (në mund të ketë)! Ai u ngrit së bashku me mua. Vendosi të më shoqëronte. Dolëm.

Unë provova disa herë për ta marrë vetë fjalën në mënyrë arbitrale, duke shpresuar se kësh-
tu do të mund ta vija në heshtje cicërimin tim.
Por shpejt u binda se njeriu pa përvojë nuk duhet
dhe nuk bën të turpërohet kaq haptas. Ç'të du-
het? Kur s'di, s'di. Rri në punën tënde dhe mbaj
vesh të tjerët! Se Farunit mund t'i marrësh shu-
më gjëra, por fjalën, meazallah; as mos e shko
nëpër mend një heroizëm të tillë! Nuk ma ha
mendja të ketë lindur qoftë dhe vetëm një burrë
nëne i aftë për këtë vepër historike.

I palodhuri Farun po numëronte për të 187-ën
herë formacionin e «Ranxherit» kundër «Çeltikut»
të Glaskout!

Unë po kërkoja një taksi, që ta përdorja si
komandare shpëtimi ndërsa vigani Farun vijonte të
fliste mbi takimet, golat dhe formacionet.

Edhe kur dolëm në sheshin Skënderbej, Fa-
runi nuk pushonte. Sapo heshti pak, te skandali
«Shishet e thyera», për shkak se ngatërroi frymë-
marrjen nga nxitimi, ndala një taksi. U futa vetë-

timthi brenda dhe i thashë shoferit t'ja shkelte
gazit në dërrasë. Hëpërhe në drejtim: nga sytë kë-
mbët! Dëgjova zërin e Farunit që më tha:

— Dale, more, prit! Në darkë ose eja, ose pri-
tëm aty, se do të shpjegoj përse Shulci refuzoi...

Por unë tashmë isha jashtë çdo rreziku.

SI U BĒRA KAMPION

Çdo ditë bënim tri orë stërvitje. Ishim prapa si me preqatitjen fizike, ashtu edhe me atë teknike. Duhej të djersinim më tepër.

Të dhënë kaq me zjarr pas stërvitjes, askush nuk u kujtua pér peshat. Vetëm dy javë para kampionatit, njëri nga ne pyeti trainerin.


— Kur do peshohemi, shoku Gani?

— Mirë që ma kujtove — ja ktheu ai. — Do peshohemi sonte pas dushit.

Mua më duhesin plot 85 kilogram. Kisha shpresë të isha brenda, jo vetëm sepse nuk vuaja nga oreksi, po edhe pse ndjehesha si i rëndë në vetëvete. Ndërsa kandari na alarmoi si mua, ashtu edhe trainerin dhe shokët: 79 kilogram. A mund të shtoja edhe gjashtë kilogram në dy javë me rru-gë normale? Dieta e posaçme filloi që të nesërmen.

Në mëngjez një dopjo makarona, pastiço, tas-qebap dhe një kilogram kos.

Dreka një gosti e vërtetë: dopjo pastiço, fasule me mish derri nga më të majmët, një kilogram kos dhe dy dopjo sytliaç. Darka po kaq.



Gjumi, helbete, shumë i rëndë e plot ëndrra të llahtarshme. Më fanepseshin gjithfarë gostish, banke te nga më të pasurat, ku vetëm unë duhej të haja gjithshka.

Dieta më ish caktuar më saktësi shkencore. Traineri kish eksperiencë të madhe për këtë. Ai më ndaloi rreptësish dushin pas stërvitjes. Re-gjimi ishte tepër i rreptë. Ose do të rrija i shtrirë, ose do të flija. Më ndaluan kinematë, teatrin, operën dhe stadiumin.

Më në fund më ndaluan të flas, të dëgjoj dhe të lexoj. Makaronat dhe fasulet m'u mérzitën aq sa mallëkoja veten dhe thosha se sa mirë do ishte sikur të kishim dy stomakë, fundja stomaku numër dy të ish si pjesë këmbimi ose të mobilizohej në raste të jashtëzakonshme si këto. Iu ankova trainerit, por më kot.

— A e di ti, shoku Tahir, se këto janë pretendime? Bota ku ta gjejë këtë dietë. Eh, kështu e kini ju sportistët, vetëm pretendime, ju njoh mirë unë.

— Më vjen shumë keq, shoku trainer, por unë...

Ai ma preu fjalën në mes dhe unë u binda.

Jetoja i mbyllur në një dhomë në hotel «Peza». Jashtë mund të më nxirrte vetëm traineri. Brenda askush nuk mund të futej veç atij.

Një ditë më erdhi gruaja në dhomë për vizitë. S'e kuptova si kish mundur të futej, pasi sportelistët kishin marrë urdhër të prerë të mos linin këdo qoftë.

— Ç'është ky djall sporti, more burrëziu? — filloi ajo nga sulmi. — Mblidh mendjen se u bëre

burrë me fëmijë e nuk të kanë lezet këto gjëra. Nuk je më 22 vjeç. Fëmijët të kërkojnë nga mën-gjezi në darkë. Pastaj më duket se je shëndoshur më tepër nga q'duhet. Eja, çohu tani të shkojmë në shtëpi, se fëmijët s'i zë gjumi pa ty.

E dëgjova i qetë, (megjithëse edhe të dëgjuarit më qe ndaluar), por meqë nuk mund t'i flisja, u përpoqa t'i them me shenja këto: «Ti, gruaja ime e dashur, që ke fatin të jesh bashkëshortja e një kampioni, duhet të më kuptosh drejt tani. Kështu nendon edhe traineri. A e kuption, e dashur? Më fal, por urdhërat janë urdhëra».

Mirëpo gruaja, që nuk po merrte vesh hiç nga sa i thoshja, u alarmua.

— C'janë këto shenja, more i zi? Pse nuk flet? Ja, po i telefonoj doktor Metos. Ama i bukur sport!

Ajo brofi në këmbë pér të telefonuar, pa vënë re shenjat e mia, me të cilat unë doja t'i thoshja se isha më i shëndoshë nga doktor Metua, vetëm që më kishin ndaluar të flisja. Në këto çaste hyri traineri.

— E dija unë e dija. Gratë kanë futur djallin në shishe dhe jo të mos futen në hotel «Peza».

Unë po me shenja e sigurova trainerin se ime shoqe apo kish ardhur dhë se goja ime nuk qe hapur fare. Traineri, që më kuptoi shumë mirë, më shtrëngoi dorën dhe i tha sime shoqeje.

— Ju kini një burrë të mrekullueshëm. Pas katër ditësh do t'ju kthej në shtëpi një kampion. Në këtë peshë nuk para gjenden sportistë.

— Mirë shoku trainer, po më duket se ai i ka kaluar tetëdhjetë e pesë kilogramët.

— Vërtet thua? Nga e more vesh ti këtë? —

dhe traineri po më shikonte me dyshim. — Nuk më besohet. Pa çohu, shoku Tahir.

Dualëm të tre. Pesha tregonte 93 kilogram. Traineri rrihte ballin me pëllëmbë si i çakërdisur.

— Duhej të kishit qenë më vigjilentë, shoku Tahir. Nuk duhej të kishe lakuar kaq shumë për të ngrënë.

Unë mblođha supet dhe po i tregoja me shenja se... por ai ma preu shkurt.

— Léri tani ato djall shenja. E pabëra u bë. Folë e ulëri sa të kesh në kokë. Do mbash pehriz.

Më urdhëruan këtë dietë: në mëngjez një orë gjimnastikë esëll, 30 minuta dush, gjysmë filxhan ni kafe, një kokërr portokalle, një filxhan çaj pa sheqer, pastaj do fillonte krosi i paraditës me itinerar: bankë, kinostudio, gurore, kampi i Dajtit, kala ja e Petrelës, liqeni artificial dhe që aty drejt banjos publike.

Dreka 50 gram mish, 50 gram bukë, gjysmë vezë e zier, gjysmë gote ujë, një kafe pa sheqer dhe dyzet minuta dush. Pastaj vinte përsëri krosi. Dar ka — 30 gram peshk, 20 gram barishte, 30 gram kos dhe asnë pikë ujë. Kështu fillova të përleshem me regjimin e ri sportiv.

Megjithëse itinerari nuk zbatohej pikë për pikë, mua më dukej se përshkoja me vrap të gjithë rrugullin në atë krosin tim ditor.

I shikoja me zili shokët, kurse unë isha lindur për t'u fliuar. Kujtoja me mallëngjim ditët e bukura, kur edhe unë haja ç'të doja e sa të doja. Po a rrihet pa ujë? Etja filloi të më torturojë

kaq shumë, saqë vetëm atë kohë e kuptova përse tre të katërtat e rruzullit janë mbushur me ujë.


Fare pak shpresë kisha për të fituar titullin kampion. Më në fund arriti dhe dita e kampionatit. Për çudi, me peshë isha në rregull, vetëm se ndjehesha mjaft i këputur ngå krosi dhe nga të pangrënët.

Puna ishte të mbahesha si të mbahesha deri në fund. Kisha vetëm një kundërshtar jo fort të shëndoshë, por më barkmadh nga q'dukej.

Në peshën e provës vura re se i mungonin dy kilogram. Ai u kthye pas pesë minutash me sy të zgurdulluar dhe me bark më të rritur.

Dualëm në tapet. Doja ta zija për mesi, por më pengonte barku i tij i madh. Më ndihën krahet e mi të gjatë. E shtrëngova mirë, e shtrëngova akoma më fort. Dhe në çast më mbuloi një dush i fortë uji me presion prej tre atmosferash e gjysmë, të paktën. S'po kuptoja asgjë. Salla, që po më vinte rrotull, buçiti nga të qeshurat. Dhe kjo më habiti më tepër. Ç'ka për të qeshur kur tjetrin e mbyt uji? S'e kuptoja se ku kishin plasur tubat e çesmës dhe ku qenë hidraulikët! Më në fund u bë e qartë se dushi po shpërthente dy kanalësh nga goja dhe hunda e kundërshtarit tim që u skualifikuva.

Deri në dhomën e veshjes arrita me këmbët e mia, por atje u këputa e rashë pa ndjenja. As që më shkonte ndër mend për tifozët, që duartrokisnin kampionin e fikur.



KOHA E HUMBUR

Isha duke dëgjuar në radio simfoninë opus 123, kur papritur trokiti dera dhe me shpejtësinë e furtunës u fut brenda Bashkimi. Ritmi i tij nuk pajtohej aspak me kohën e melodisë, që tanë ishte ulur në pianissimo.

— Alarm — shpërtheu Bashkimi.

— Ç'lloj alarmi? — e pyeta ftohtë.

— Alarm ujor. Trainieri na pret me urgjencë.

Se përse, nuk na tha, po me siguri këtu diçka lot. Çohu, pse më shikon si i çakërdisur? Nuk të mbushet mendja, se gjëndja është tepër serioze? Çohu, pra! Trainieri na pret.

U çova dhe u vesha. Rrugën e bëmë me nxitim, tamam si në ecjen sportive. Trainieri jo më kot e prish gjakun, pra me siguri diçka alarmuese duhej të kishte ngjarë. Rrugës u përplasëm me dy biçikleta, përmbyshëm një karro të komunales, pastaj shtypëm një maçok. Pra, ecnim si të bënim nxemien përpara mbledhjes, të cilën e çeli vetë trainieri.

— Shokë, — ja filloi ai — situata është tepër kritike! Është më kritike nga ç'mund ta merrni me mend. Unë isha i mendimit se, meqë vjet në kampionatin kombëtar zumë vend nderi, sivjet nuk do të qe nevoja të merrnim pjesë në këtë aksion sportiv. Të çlodheshim një vit, pastaj e dinim vettë. Por kryesia e klubit nuk qe dakord me mua. Sot më thirën dhe ma bënë lëkurën për dush të ftohtë. Pra, jo vetëm që do marrim pjesë në kampionatin kombëtar të sivjetëm, por duhet që patjetër të zëmë vend nderi. Diskutime nuk ka. Dhe, tani, drejtim detit me vrapi, marsh!

— Si, menjëherë në ujë? — pyeta unë.

— Menjëherë, dhe nën ujë bile — u përgjegj lakonik trainieri.

U futëm në ujë pa bërë fare nxemie, duke pandehur se qe një rast i mirë për t'u stërvitur lirisht. Por, sa po hymë në det, u dëgjua urdhëri i trainierit.

— Pas meje, gati për 3.000-metërshin.

Ne e morëm këtë për një shaka, por këtë herë nuk ish dita e shakave. Dhe trainieri nuk ish në humor si përherra. Me një fjalë, në vend të **nxemies**, bëmë **3.000-metërshin**. Kur dolëm në breg, mua më dukej sikur **mushkëritë** më **kishin ardhur** te gryka. Bëmë ca lëvizje të lehta për t'u çmpirë, por **çlodhje** nuk **ndjenim**. Nuk po ngopesha me ajër dhe besoja se asnijëherë nuk do të arrija të ngopesha me ajër dhe besoja se asnijëherë nuk do të arrija të ngopesha me këtë element kaq të bollshëm. «Sapo që puna qëndron kështu — thashë me vete, — atëherë mua me siguri duhet të më jenë çarë **mushkëritë**...»

U nisa për në shtëpi, duke ecur, ashtu siç ecën

një njeri, i cili mendon se i janë çarë mushkëritë.

Për darkë kishim fasule, por unë s'desha t'i haja.

— Si është puna, mor bir? Ti vetë më ke thënë kaq herë të gatuaj fasule — më pyeti nëna.

— Të pata thënë dikur, por jo sonte. Fasulet nuk më bëjnë mirë pér mushkëritë — ja ktheva.

— Fasulet pér mushkëritë? — pyeti ajo e çuditur! -- Ti nuk je mirë sonte — dhe më kapi pulsin. Pastaj më vuri dorën në ballë, po vështirë të ketë marrë gjë vesh nga këto hetime.

Të nesërmen, po qe se do përsëritez prapë 3.000-metërsi, kisha vendosur të kundërshtoja energjisht kisht. Dhe ashtu bëra.

— Shoku trainier, unë jam pér distanca të shkurtera, q'më duhet mua 3.000-metërsi? — pyeta.

— Atë e di unë — m'u përgjegj ai. — Distancën e gjatë e shkurton kur të duash, por të shkurtërën nuk e zgjat dot, po s'qe i preqatit fizikisht — vijoi sqarimet trainieri.

Stërvitja e përditshme vazhdonte me vrull. E kishim kapur demin pér brirësh. Me gjithë këto, unë ndjehesha i lodhur, dhe jo në formë si zakonisht. Herë pas here kisha dhe marrje mendsh. Diçka nuk ishte në rregull, po hajde ta gjeje.

— Mos na dëmton kjo stërlodhje e përditshme, shoku trainier? Dhe një javë e dalim në garë — sugjerovala unë.

— E ku është dëgjuar kjo, mor pëllumb? Si ka mundësi një gjë e tillë?! Mos vallë unë pér të parën herë preqatit ekipin pér kampionat? Jemi shumë prapa! A e kuptioni ju këtë? Në këto ditë që na kanë mbetur duhet të fitojmë kohën e humbur.

Unë e kuption, kjo punë duhej bërë pak nga

pak, por tani nuk ka vend për autokritikë. Këtë do ta sigurojmë më mirë në analizën vjetore. Ndërsa tani na duhet të çajmë ujërat e detit si delfinët. Dhe pas një javë na duhet rezultati dhe vetëm rezultati: një vend nderi në klasifikim. Pra, shokë, mos u kursemi. Duhet të sakrifikojmë. Mos kini merak. Për çlodhje do kini kohë fill pas kampionatit. Bile, atëherë, unë do ju urdhëroj të rrini shtrirë dhe vetëm shtrirë!

Dhe ne përpinqeshim të fitonim kohën e humbur, duke notuar 5.000 metra në ditë, sipas të gjitha stileve zyrtarë e jo zyrtare.

Kështu po e prisnim ditën e kampionatit. Dhe dita erdhi. Mua trainieri më caktoi 100-metërshin stil flutur, shpinë, stafetën dhe 400-metërshin.


U bëmë gati për të 100 metrat stil flutur me të cilin do të çeleshin dhe garat e kampionatit. Kineastët dhe fotoreporterët prisin në gadishmëri. Isha tepër i ngashëryer.

Sapo u dha sinjali, rashë në ujë si një predhë reaktiv. Nisjen e bëj gjithmonë të rrufeshme. Finishin pastaj, tjetër punë.

Por kjo nuk vijoi gjatë. Trupi po më rëndohej. Në kokë diçka si marrje mendsh po më prishte ekilibrin. Dhe për notarin këto të dyja janë të mjafta. Me sa kuptoja, davanë e kisha të humbur. Fun-dosesha poshtë e më poshtë... Gojën nuk munda ta hapja, meqenëse trainieri kish këhë që nuk i dë-gjonte dot ankesat e mia. Rashë në fund të ujit dhe u shtriva i kënaqur mbi rërën e mëndafshtë...

... Një dorë e fortë më prishi këtë qetësi dhe rehat puplash...

Kur erdha në vete, pashë se isha në spital...



Në fillim u përpoqa të sqaroj lidhjet kauzale midis kampionatit kombëtar të notit dhe spitalit, por kjo më qe e pamundur.

Ju drejtova për ndihmë fqinjitet tim më të djath-të, kur ç'të shikoj? Ish trainieri im!.. Të qe e vërtetë... Çudi!

— Shoku trainier, shoku Viktor. Po ju këtu? Mos është shtruar i gjithë ekipi?

— Jo, vetëm ne të dy! Shyqyr që shpëtovë.

— Falemnderit. Edhe ju shyqyr që shpëtuat! Po si ndodhi kështu vallë? Mirë unë, po ju?

Dhe ai më sqaroi qetësish. Sa e kish parë që kisha humbur ndjenjat, ish hedhur me rrëmbim në ujë të më shpëtonte. Po ashtu, i kapitur jashtë mase siç kish qenë, nuk më kish ngritur dot dhe kish humbur ndjenjat po aty pranë meje. Në këtë gjëndje, bateria e dytë së bashku me zhurinë dhe me disa nga spektatorët na kishin shpëtuar jetën... (Dhe thonë pastaj se sporti nuk ka asnjë rrezik!)... Tani në poh fitonim sërisht kohën e humbur...

Në kundërshtim me traditat e përvitshme, kur unë prisja urimet e zakonshme si kampion, këtë herë prita urimet e jashtëzakonshme, që shpëtova nga pa-sojat e orvajtjes për titullin kampion.

POLINJERIU

Atë ditë nuk mund të rrëja më shumë aty, sepse duhej të hidhesha një vrap deri në Levan. Veçse Xhevdeti, llogaritari i kooperativës, po më vononte. Unë e prisja në vatrën e kulturës, deri sa të kuadronte pasqyrën e shtesës në peshë të derrave.

Derrat janë të urtë, dhe si të tillë në peshë shtojnë lehtë.

Po për t'i kuadruar pasqyrat e tyre është një punë më e vështirë, se sa shtesa e peshës.

Më në fund nuk m'u durua dhe u nisa për në zyrën e llogarisë.

— Xhevdeti ka shkuar në fushën e sportit — më sqaroi një shoqe atje.

— Në fushën e sportit? Mos ka vendosur ta kuadrojë atje pasqyrën e derrave? — e pyeta.

— Jo, ai me derrat mbaroi; tani po merret me skuadrën e futbollit, mbasi pasnesër do të kemi ndeshje me Levanin.

Ika i hutuar dhe pa e zgjatur për të mos u hutuar më tepër. Kërkova një lidhje logjike, orga-

nike apo administrative midis derrave, futbollit dhe llogarisë. Por më kot. Dihet se derrat janë derra dhe nuk marrin vesh as nga llogaria dhe as nga futbolli.

Xhevdetin nuk e gjeta as në fushën e sportit.

— Futbollistët e janë për mbas dite ndeshjen pregititore. Trainieri, Xhevdezi, u nis për në vatrën e kulturës, mbasi ka provat e korit — më sqaroi një i ri.

— Si, qenka edhe trainier?

— Po!

— Edhe me provat e korit?

— Po! Vecse këto janë pak. Ai merret edhe me teatër!

— Jo, more!

— Përnder po. Është aq i hedhur, sa nuk ta pret mendja.

— Mos merret edhe me balet? — pyeta më tepër me ironi, se sa me shaka.

— Drejton grupin e valleve.

— Stop! Këtu e tepërove, djalosh.

— Përnder jo. Nuk të besohet, po ja që kështu është.

— Jo, more! E si ka mundësi kjo?

— Për këtë pyet kryesinë.

— Po kryesia ç'hyn këtu?

— Hyn që ç'ke me të.

— Si kështu?

— Ja, kështu... — Dhe djaloshi nisi të më tregojë.

... Para tre vjetësh rrathi kërkoi një të ri nga kooperativa jonë. Dë mësonte nëntë muaj në Tiranë për llogari. Kryesia nisi Xhevdetin. Djalë i gjallë, i hedhur dhe gojëbrisk.

Gjashtë muaj pas ikjes së Xhevdetit, rrathi kërkoi një të ri për kursin tremujor të fisarmnikës. Fshati dalëngadalë do të krijonte grupet artistike, korin, orkestrën e të tjera.

Kursi i fisarmonikës hapej pikërisht pas mbylljes së kursit të llogarisë. Prandaj kryesia gjykoj kështu. «Ne nuk kemi aq krahë pune sa pandeh rrathi. Atë që nisëm, po! Po tjetrin ku ta gjejmë? Fundja Xhevdeci është që është në Tiranë. Sapo të mbarojë me llogaritë, t'i futet harmonikës. Kështu nuk do kemi as shpenzime transporti».

Dhe, ashtu u bë. Sapo Xhevdeci mbaroi kursin e llogarisë, u kthyte nga solfezhi. Iu desh ca kohë deri sa të ambientohej, por si të tjerë dhe ai. Shifrat nga notat nuk kanë edhe aq ndryshim siç pandehin disa. Nga debi-kreditë në doremi-fasol nuk të ndajnë vetëm disa nota.

Tani Xhevdeci në vend të formularëve dhe të pasqyrave, mbushte pentagramë me nota dhe zërthente gjithfarë ushtrimesh solfezhi. Në vend të çelëseve të llogarisë, që ëndërronte të merrte pas mbarimit të kursit, mbeti me çelëset e solit në duar.

Shpesh, nëpër pentagram, në vend të notave, shënonte shifra. Pastaj i prishte prapë shifrat dhe i zëvendësonte me nota.

Koka gjithë, ditën i buçiste nga harmonika, tromba, zurnajá, gërneta e nga gjithfarë instrumentesh të tjera zhurmënidhë. Këto e shqetësonin sidomos në fillim, aq sa dhe gjumin nisi ta bëjë me kohë dhe me nota..., alegro, vivaçë... 3/4... skerco... 1/4...

Disa ditë përpara se të mbaronte me sukses

kursin e fisarmonikës, kryesia e njoftoi Xhevdetin, se do kalonte në një tjetër kurs. Tani ishte fjala për aktivist sporti. Kështu Xhevdeti kërceu nga pentagrami në pistat dhe fushat sportive.

Solfezhi me sportin lidhet në çdo kohë. Sportin pa muzikë mund ta kuptosh sa dhe muzikën pa sport.

Tani, Xhevdeti, në vend që të mbushte formularë me nota apo pentagramë me shifra, vra-ponte. Pas vrapimeve, vinin kërcimet: së gjati, së larti, me shkop e pa shkop. Këtu ai djersinte nga mëngjezi deri në mbrëmje. Dhe kjo e djersitur i kujtonte kooperativën. Sepse atje në fshat, me këtë djersë mund të siguroje dy ditë pune në ditë, or babam!

Apo nuk duhej të qe zverdhur gruri tani atje. Së shpejti fillonin korrjet, shirjet... Lëmi i fshatit, festa e bukës, era e freskët e kashtës dhe e grurit të shkoqur, thasët e mbushur plot dhe në mbrëmje, petulla e byrekë me miellin e ri. Se byrekë dhe petulla kish dhe në Tiranë, po këtu ndryshonte puna. Ka petulla e petulla.

Si mbaroi edhe këtë kurs, Xhevdetin e futën në një kurs tjetër për koreografi. Kërcim për kërcim. Vëtem se tani do të merrej me kërcime artistike, kërcim me nota, që për pak desh i harroi.

Dikur mbaroi edhe ky kurs. Kursi, por jo kurset!

Vazhdoi me ski dhe alpinizëm. Kjo Xhevdetit i dukej fare pa kuptim. Të bridhje majë më majë e shkrep më shkrep, kur fare mirë mund të ruaje lopët e kooperativës, nuk duhej lejuar. Po urdhëri urdhër.



Xhevdetit nuk po i zinte këmba dhe. Bile atë e mori malli si për fshatin ashtu edhe për njerëzit. Sikur t'ja kishin llogaritur kohën me kronometër, që nga kursi në kurs të mos i mbetej asnjë ditë pushim. Prej andej e nisën në fermën e pulave për eksperiençë. C'është e vërteta ajo kish qenë fermë derrash, megjithatë puna u bë. Ferma e pulave ish ngritur përtejë fermës së derrave, si duket për preçedencë. Pas kësaj e dërguan në një tjetër kurs për kanotazh dhe hipizëm. Dhe nuk dihej në do kthehej ndonjëherë në fshat, apo do mbetej tërë jetën kurbetit, sikur në hipizëm të mos kish ndrydhur këmbën. Iu desh të bënte një muaj pushim, rast me të cilin takoi edhe njerëzit e përmallur.

Gjatë muajit të pushimit, lindën të tjera nevoja urgjente për të dërguar njerëz në kurse të ndryshme. Vetëm atëherë kryesia u kujtua, se në fshat kish dhe të tjerë të rinj të aftë për këto punë.

SKANDAL NË STADIUM

Ecja rrugës i qetë nën ritmin e disa kujtimeve të vjetra. Në këto kujtime më shtyu albumi fotografik, të cilin e shfletoj herë pas here. Pashë mjaft nga shokët e shkollës, midis të cilëve edhe Shefki Sheqerin. Rrinim në një bankë dhe bënim rrëmuje të gjitha bankat. Edhe nga mësimi, për thyerje dishiplinore, dilnim bashkë jashtë në shenjë solidariteti.

Luanim dendur futboll, por asnjëherë në skuadra kundërshtare. Ne nuk ndaheshim. As në futboll, as në kinema, as në domino dhe as në brigadat kulturale. Vetëm në mbasditet e dëfrit mit nuk kërcenim së bashku. Shoqet e klasës nuk do të na e lejonin një sfidë të tillë...

Edhe në provime hynim e dilnim njëri pas tjetërit. Notat po ashtu i merrnim të përafërtë: një më lart, një më poshtë. Por ndryshimet përbushnin njëri tjetrin, si në disa inventare fizike.

Edhe në latinishte të dy u kthyem për në shtator...

Që atëhere nuk e kam takuar më Shefkinë.

Pyes dendur për të, por pak lajme të sakta kam marrë. Disa thonë se u martua, disa të tjerë thonë se u nda. Të tjerë thonë se është bërë shef. Mua më bëhet qejfi kur ndonjë shok i fëmijërisë ecën në jetë. Në këto raste ndjej një gëzim të sinqertë dhe fëminor, tamam si ahere kur vilnim qershitë e teto Marisë.

Më pas lexova dhe një artikull në gazetë nga pedagogu Shefki Sheqeri. Pra e kish mbaruar edhe fakultetin.

Unë vetë fillova të shkruaj ca më vonë nëpër gazeta. Po ashtu, për arësy personale, edhe fakultetin e kreva ca më vonë nga vërsnikët...

Një ditë nxitoja për në opera, se më kish vajtur vonë. Kam provuar, se sa herë që nxitoj për diçka, do ngjasë ndonjë e pabërë. Kështu edhe atë ditë, tamam përpara birrarisë «Partizani» u përplasa me një kalimtar. Karamboli nuk qe dhe aq i fortë, meqë nuk pati as thyerje, as shembje dhe as hemorragji të brendshme.

— Më falni — i thashë.

— Ju lumtë!

— Mua m'u duk si zë i njojur. Po s'kisha si ta pyesja sérish.

— Më falni, po...

— Ju lutem! — përsëriti ai me njerëzi, por jo i hutuar si unë.

— More, më falni, po sikur, dikur, më duket se jemi parë.

Ai ngriti vetullat duke radhitur një diagram rrudhash mbi ballë, pastaj tha:

— Për nder edhe unë diçka po kujtoj, por jo qartë.

— Ku e keni bërë të mesmen.

— Këtu. Po ju?

— Mos jini Shefki Sheqeri?

— Shiko, shiko! Ziguri qënke ti, more?

Me këtë rast e lashë vendin bosh në opera dhe u kthyem në birrari. Mbaj mend se, në opera, dendur mbeten vende bosh, pra ka mundësi që edhe mungesa ime të mos ndjehej.

Kujtuam, e ç'nuk kujtuam, thuaj. Pas pak erdhi një shoku im dhe pasi na mori leje, m'u drejtua.

— Trainieri më porositi t'ju them, se nesër në orën 17 kemi garë kontrolli. — Kaq tha dhe u largua. Shefkiu po më shikonte tanë me një farë habie. Kjo nuk më shqetësoi, mbasi dihet mirë, se në botë ka ende mjaft fenomene që të habitin, por nuk të shqetësojnë.

— More Zigur, nuk më thua, ç'qe ai trainieri dhe ajo gara e kontrollit që të zuri në gojë ai shoku qëparë? — pyeti Shefiku.

— Është trainieri im. Ai shoku është anëtar i ekipit tonë dhe nesër kemi garë kontrolli, mbasi pas dy javësh zhvillohet kampionati.

Shefkiut ndërkohë nuk di pse birra i shkoi ters dhe u mbyt në kollë. La gotën dhe nxori shaminë. Po kolla nuk i ndahej. Kështu më duket se ngjet kur njerëzit kanë gurmaz të ngushtë.

— More Zigur... more Zi... gur... Po ç'është ky sport, more? Akoma merresh me sport ti?

— Pse, ç'të keqe ka në këtë mes? — e pveta.

— Si, more, ç'të keqe! Po ti tanë je njeri serioz. Je i rritur. Për më tepër edhe kuadër. Çudi, çudi! Unë kam pasur respekt për ty.

— Pse, tani nuk ke më respekt për mua?

— Jo, xhanëm, nuk desha të them këtë. Por, sidoqoftë, një kuadër, një shok i ngritur të merret me sport! E habitshme!

— Dëgjo, Shefki. Ti ke qenë çapkën dikur, por në shaka nuk të ka ecur. Që kur paske filluar nga qyfyret?

— Unë nuk bëj shaka. Unë jam njeri serioz në jetë. Ishim si ishim dikur, fundja fëmijë ishim. Tani ndryshon puna.

Jo vetëm puna, por edhe Shefkiu kish ndryshuar. Në raste të tillë, nuk di pse më është bërë zakon t'i shikoj njerëzit nga veshët!

Po, Shefkiu kish ndryshuar. Ai qe trashur përmbi normat mesatare statistikore.

Edhe veshjen e kish mjaft serioze për moshën e tij. Po një pamje të tillë i kishin marrë edhe tiparet e fytyrës, për të cilat unë nuk guxoj të zgjatem.

Takimin e dytë të papritur me Shefkiun e pata në radhët e tribunës së stadiumit.

Pa arritur të zija vendin që më përkiste atje, filloi loja... Filloi loja, filloi edhe Shefkiu. Domethënë filloi të luante edhe ai. Luante me këmbë, me duar dhe me veshë. Bile, edhe sikur të kish pasur disa gjymtyrë të tjera, besoj se do ta ngatërronte gjysmën e stadiumit.

— Shefki mbaj veten, a derëzi. Ma zhvate një copë lëkurë në zverk. Ti e di mirë që lëkura e zverkut më përtërihet aq lehtë sa ajo e hundës.

— Por ai nuk dëgjonte. Vërvëllente, ulërinte, shante në të gjitha dialektet, kërcënohej, ndëshkonte dhe parashikonte.

E q'më bredhin poshtë e lartë katundve mble-dhësit e folklorit? Harxhojnë edhe dietat e shtetit edhe këpucët e tyre! Përse nuk inçizojnë këtu Shefkiun? Pastaj ata shokët e gjuhësisë, q'na përrallisin, se fjalori ynë vetëm pas disa pesëvjeçarëve do t'i arrijë të 100 mijë fjalët?

Shefkiu nuk po ngopej dot me ulërima, sharte dhe vërvshëllima. Pastaj filloj të kërcejë. Dhe në çfarë stilesh: së larti, së gjati, pogonishte, napololin, vallen dyshe elbasanë të përzier me një dozë fokstroti ende të pazbuluar.

Unë e shikoja dhe çuditesha! Ishte apo nuk ishte ky Shefkiu? Po të qe dora vetë, a i kish hije një sjellje e tillë? Po të mos qe... Sidoqoftë, nuk më vinte keq për të. Edhe keq edhe rëndë. Si do t'i dilja përpara ndonjëherë këtij shoku kaq serioz në jetë?

Për një ngatërrresë në portën kundërshtare, Shefkiu, bubulloj: Penallt! Peeenallt, arbitër! Por arbitri nuk arriti të kapë sugjerimin objektiv dhe serioz të Shefkiut. Miku im shpërtheu si furtunë.

— Skandal, kjo nuk lejohet, kjo nuk falet! Skandal! Ku është federata? Ku është drejtoria? A ka më drejtësi?

Meqë ishin sekondat e fundit të ndeshjes, unë u ngrita, duke mos e sqaruar dot mikun tim të fëmijërisë lidhur me skandalin dhe mbi drejtësinë! Se drejtësia nuk mund të vihej në vend brenda disa sekondave, ashtu siç luan shpesh nga vendi, brenda disa sekondave, dinjiteti i një njeriu me kulturë!

KRITIKA VERTIKALE

Shoku Ismet po rrinte i vetëm në kabinetin e tij dhe mendohej në duhej ta ndjente veten të fyter nga kritika që sapo i qe bërë, apo nuk duhej. Ndokujt mund t'i duket qesharake një përpjekje e tillë, por mjafton ta provosh kritikën në kurzin tënd dhe menjëherë të ndërrrosh mendim.

Shoku Ismet ndezi një cigare. Një zë i thosh se nuk duhej të fyhej aspak, mbasi kritika ishte e drejtë, mbasi ai me kohë duhej kritikuar pér këto gjëra... Mirëpo, pa mbaruar ky zë, e ndërpriste një tjetër zë i rëndë e i trashë si bas i ngjirur... «Jo, patjetër duhet ta ndjej veten të fyter. Përse këto gjëra të më thuheshin përpara kolektivit, përpara vartësve? Ç'autoritet do të kem unë tanë në sytë e tyre? Si do t'i urdhëroj ata, si do t'ua fut këmbët në një këpucë, kur të gabojnë? Pse, a nuk pati mundësi shoku Raqi të m'i thoshte pak më-njanë këto gjëra? Po! Atëherë më thuaj, të lutem, pse veproi kështu? Apo që të më diskretitonte! Vazhdo, shoku Raqi, vazhdo se e ke mirë! Po e

ngrë autoritetin tënd në shpinën time. Se është lehtë të vish i deleguar nga Tirana, të kritikosh majtas, pastaj të kthehet prapë në Tiranë.»

Përveç kësaj, shokun Ismet e trishtonte edhe diçka tjetër. Bile, jo vetëm e trishtonte, por i lidhte edhe duart; e trishtonte vetë fakti se ish kritikuar jo nga poshtë e lart, por nga lart poshtë. Kësaj si i bëhej? Kjo s'kishte ilaç. Po, po të qe nga poshtë lart, ndryshonte puna. Bëhej ç'bëhej dhe gjendej ndonjë marifet për t'i mësuar njerëzit se si të kritikohet eprori. Por ç'të bësh kur të kritikon vetë eprori! Dhe sa troç ishin thënë gjërat pa!... «Shoku Ismet drejton nga tavolina. Ai nuk i ndjek fare nga afër aktivitetet kulturalo-artistike. Po ashtu aktivitetet sportive i ndjek rrallë dhe vetëm me telefon. Bile shpesh rezultatet e ndeshjeve të ekipeve tona i merr vesh nga rubrika sportive e radios në orën 21. Rastis që kërkon në raport regjisorin e estradës, kur trupa ka shkuar, fjala vjen, në Gjirokastër për turne. Po ashtu ngatërron trainierin e futbollit me atë të shahut. Ose akoma më keq. Një ditë i tërroqi vërejtjen trainierit të qitjes, duke e marrë për atë të ngritjes së peshave. Kurse i qitjes sapo qe lavdëruar nga ne, mbasi kish thyer katër rekorde kombëtare. Po a mund të drejtohet kështu, shokë?

Dhe shoku Ismet dëgjonte! Shikonte dhe dëgjonte... Ndërsa tani nuk dëgjon gjë tjetër përveç dy zërave të brendshëm, që kundërshtonin njëri-tjetrin.

«Kritikën duhet ta pranojmë se ajo na shëron, se ajo...»

«Mirë, xhanëm, hajde se po e pranojmë, dja-

Ili e mori, po pse të më kritikonte kaq hapur përpara kolektivit? Apo me qëllim diskreditimi? Hëm!...» mendonte me vete.

Gjithë punën shokut Ismet ja prishte kolektivi, si dhe ajo kritika e hapur përpara tij. Sidomos kritika nga lart. Se kritika nga lart është me rrëzifik. Është një kritikë vertikale. Apo nuk ndjek dhe drejtimin e shkarkimit të rrufesë, apo nuk godet me forcën e rrufesë! Kurse kritikat nga poshtë shndërrohen në korrente horizontale, që eliminojnë njëri-tjetrin. Se, përveç këtyre, ka edhe kritika diagonale, perpendikulare, hiperbola ose parabola. Ndërsa autokritika ka formën e tagenteve.

Duke kujtuar fjalët e autokritikës, Ismeti mendoi se si mund të bëhej një plan pune për të ardhmen lidhur me ndjekjen nga afér të aktiviteteve kulturalo-artistike apo sportive.

Hapi kalendarin. Java e parë ishte e zënë. Mbledhje në NBSH, në NISH Prodhime, në Komunale. Java e dytë po ashtu. Takim me novatorët e Uzinës Mekanike, mbledhje për fushatën e mbjelljeve, sesion shkencor mbi rritjen e derrit. «Po ç'të bëj, pra, kur të gjitha ditët i kam të zëna? Mund të lë derrat dhe të merrem me sportistët? Çudi, përsë venë e më kritikojnë! Të ish për problemet ekonomike, po edhe hahej. E ç'mund të bësh pa arritur realizimin e planit të prodhit? Ekonomia, mor vëlla, është baza. Kurse sporti dhe arti i përkasin superstrukturës! Apo jo? E, apo mos e kam gabim? Jo, jo, kështu është. Superstrukturës...» mendonte.

Shoku Ismet vijonte shfletimin e kalendarit. Por ditët ishin të zëna... Takim me mjelëset e

dalluara, takim me viçat e rritur, desha të them, me rritëset e viçave, mbledhje mbi kooperimin, diskutim mbi...

Më në fund java e katërt ishje lirë. Ismeti hapë kalendarin sportiv për atë javë dhe pa se skuadra e tij e futbollit kish nuk ndodhej në Korçë.

Larg! Shumë larg, bile! Sidoqoftë, diçka duhej bërë. Shënoi në faqen përkatëse të kalendarit «nisem për Korçë» dhe ktheu sërisht fletët.

Do të nisej pa i thënë gjë njjeriut. Do t'i bënte surprizë si kolektivit ashtu edhe ekipit të futbollit; dhe do hynte në stadium sapo të fillonte ndeshja. Sapo ta shikonin futbollistët, do të dyfisionin përpjekjet për fitore. Do t'u ndodhej afër në çdo gjëndje kritike. Pastaj, në minutat e pushimit, do t'u mbante një fjalim të shkurtër për t'i inkurajuar. Do të dilte gjë e bukur. Lere mos e nga. Të gjithë do ta mbanin në gojë të paktën për një vit. Dhe ashtu bëri. Atë ditë thirri shoferin në zyrë.

— A je gati, Sami?

— Gati, shoku Ismet. Nga do t'ja mbajmë?

— Rrugës e merr vesh!

Ismeti që e kish marrë me mend habinë legjitime të Samiut, nuk iu përgjegj, po i rrahu shpatullat. Ish merita e tij t'i mahnistë kështu të tjerët.

Gazi çau me uturimë përmes rrugëve të qytetit dhe, pas pak, u gjend në periferi. Ismeti i kish bërë hesapet me kronometër. Në Elbasan kafe, në Prrenjas dhjetë minuta pushim, drekën në Pogradec dhe pastaj fill e në stadiumin e Korçës, ku do të gjendej një minutë pas fillimit të ndeshjes.

Shoferi e shikonte me vëmendje herë pas here, por megjithatë nuk arriti dot të zbërthente arësyen e këtij udhëtimi të çuditshëm. Sapo arrin në ndonjë kthesë, Ismeti jepte drejtimin që duhej ndjekur me dorë. Kjo i kujtonte Samiut ditën që kish dhënë pravat për të marrë patentën. Kështu e drejtonin edhe ata të komisionit nga njëra rrugë në tjetrën. Ndërsa me shokun Ismet ai nuk kish bërë asnijëherë të tillë rrugë. Dhe asnijëherë s'kishin udhëtar me kaq urgjencë, dhe asnijëherë kaq të heshtur! Dhe asnijëherë ditën e diel. Pra këtu diç luante. Ku ta dish, detyra i ka këto!

Kur hynë në stadiumin «Skënderbeu» loja kish plot 60 sekonda që kish filluar. Ismeti pa orën e tij dhe iu bë qejfi. Tamam kronometër! Ja, kështu duhej. Po të shkonte puna gjithmonë me kronometër, le të të kritikonin sa të donin të tjerët. Në daç nga poshtë, në daç nga lart. O vertikalish, o diagonalisht!

Meqë nuk po dallonte asnijë nga lojtarët e tij, pyeti shoferin.

— Sami, nga ç'anë po lot skuadra jonë?


— Skuadra jonë? — u përmend shoferi me aq tronditje, tamam sikur t'i qenë këputur frenat fare papritur!

— Po, pra, skuadra jonë — tha prapë Ismeti, duke parandjerë diçka të pâpëlqyer.

— Këtu luan «Skënderbeu» me «Vllazninë», shoku Ismet, — u përgjegj si me zë fajtori i pafajshmi Sami.

— Si? Po ekipi ynë ku e ka thyer qafën?

— Në Gjirokastër, shoku Ismet. Eh, përsë nuk



më pyete që më parë! Ku ta dija unë se... U bë një avancim në kalendar për shkak të ndeshjeve ndërkomëtare për kupën e kupave.

— Mjaft më, se u mbush kupa dhe po derdhet bile. Eja të thyejmë qafën prej këtej. Si drequin, xhanëm, nuk respektohet grafiku i realizimit të planit, domethënë i ndeshjeve? Dhe hajde pastaj e ndiqi të tilla aktivitete. Ka rregulla këtu apo jo? — Dhe të dy njëri pas tjetrit braktisën stadiumin pa humbur kohë.

KËMBORËT

«Mjeshtërit të merituar të sportit dhe futbollistik tonë të madh, shokut L. B.»

— Si thua ti, Halim?

— Qejfi ma ka për barazim, por, sidoqoftë, nuk do ta hamë thatë. Këtu jemi në shtëpinë tonë, ku, siç thuhet, të ndihmojnë edhe muret. Po ti, Demo?

— Dhe unë barazim desha, po prapë trembem disi.

Po këshfu kish mijëra e mijëra parashikime mbi rezultatin e këtij takimi, si dhe mbi formacionet e të dy ekipeve.

Pas pak tribuna u mbush me tifozët e huaj. Ata kishin rrasur në kokë qeleshe të bardha nga tonat. Disa prej tyre se ku kishin psonisur ca zile e këmborë nga ato të eksposítës së artizanatit.

Pranë nesh u ul një grup të huajsh prej katër-pesë vetash.

— Ju sot fitoni? — na pyeti njëri prej tyre.
Nga toni dukej se e zotëronte për bukuri sarkzmën.

— Shpresojmë — ja ktheva i qetë.

— Aha, ju shpresa, — tha duke treguar një habi më të madhe nga ç'ish e nevojëhme. — Vërtet ju shpresa?

— Ne shqiptarët lakrat i ndajmë në fushë dhe jo në shkallët e stadiumit — ja ktheu Demua.

— Javol! Kjo u tha bukur. A mund ta shënojmë? — pyeti ai duke nxjerrë një bloknot.

— Ju qeleshe shumë të bukura.

— Ne çdo gjë e kemi të bukur — ja ktheu Halimi.

— Jo çdo gjë shumë të bukur. Futboll jo bukur.

— Ndeshja ende s'ka filluar — i tha jo fort me qetësi Demua.

— Dhe këto jo shumë bukur — tha ai duke treguar zilet dhe këmborët që mbanin.

— Ju pse s'mbani këmborë — pyeti ai me naivitet miku.

— Këmbora nuk mbahet, por tundet — ja ktheu po me naivitet Halimi.

— Ju sot hani pesë gola. Pse ju nuk dhatë a forfe?

— Që të mos na harronit kaq lehtë!

Në këto e sipër, skuadrat dolën në fushë dhe stadiumi oshëtiu nga duartrokositjet. Ndeshja filloi e shpejtë. Miqtë bënë një zbritje dinamike, por mbrojtja jonë u gjet në gadishmëri.

Tifozët miq e priten me duartrokositje sulmin

e ekipit të tyre; pastaj nisën të tundnin zilet e këmboërët dhe të hidhnin përpjetë qeleshet nga gëzimi.

Pastaj sulmi ynë rrezikoi portën mike dhe vëtëm pse u nxituan sulmuesit tanë, porta kundërshtare shpëtoi pér një qime. Demua kapi kokën me duar, bëri të shkulë flokët, turfulloj, nga fundi i mushkërive, pastaj tha:

— Ta marrë djalli! Ky rast nuk vjen më.

Loja vazhdonte e shpejtë dhe dinamike. Të dy skuadrat tashmë e kishin marrë veten dhe po kërkonin labirintet pér në rrjetë.

Miqtë në tribunë nuk po e ndjenin veten mirë, megjithëse ambienti ish mjaft miqësor. Zilet e këmboërët i tundnin rrallë e më rrallë.

— Kjo është e pabesueshme — tha ai që kisha përpara.

— Flakë kashte. Do lodhen shpejt — ja ktheu tjetri.

— Thatë gjë? — e pyeti i gatshëm Halimi.

— Jo, filimi nderit — ja ktheu i hutuar miku.

Atë kohë, skuadra jonë nisi një lojë me topa të shkurtër përtokë. E, megjithëse topi ecte mrekulli pér tokë, mysafirët nuk i mbante toka dhe nisën të çohen më këmbë dalëngadalë.

Panua afrohet drejt portës. Shulci del nga istikami. Panua qëndron papritur, gjë që Shulci nuk e kish parashikuar dot. Stadiumi çohet më këmbë. Shulci humbet duelin dhe ekuilibrin. Panua afrohet. Gjuan. Miku pranë meje mbulon sytë me duar. Shut-shtyllë!

— Si jeni nga zemra? — pyeti Demua mysafirin përpara meje.

— Ju sulm tmerr... brrr... — ja ktheu ai pa qejf.

— Mos kini gjë ftohtë? Merrni një rum. Ne kemi rum shumë të mirë — e këshilloi Halimi, tashmë i papërmbajtshëm si Panua. E, megjithëse unë i shkela syrin të frenonte, ai vijoi. — Ju sot do të hani pesë gola!

— Kjo skuadra, që humbi atje? — pyeti ai.

— Kjo e tëra.

— Kjo? Pamundur. Atje ndryshe... këtu s'marr vesh. Të gjithë albanezë?

— Denbabaden! Që nga pellazgët.

— Ju s'kini blerë ndonjë brazil?

Ne ja dhamë gazit, mbasi as që e prisnim një pyetje të tillë. Unë doja t'i përgjigjesha, por nuk e mbaja dot të qeshurit. Miku u hutua dhe ish rrezik të humbte durimin, gjë që njerëzit e kulturuar s'e kanë për zakon. Duke mos dashur që ata të vinin në pikëpyetje mirësjelljen e tyre, iu përgjegja.

— Ne as blejmë dhe as shesim njerëz. Kjo do ta fyente shumë një komb të kulturuar.

— Jo njerëz, por futbollistë apo trainierë, — sqaroi ai.

— Pse, këta nuk janë njerëz?

Miku e kuptoi ironinë. U mat të thoshte diçka, por Shulci e la prapë në baltë. Stadiumi oshëtiu. Ne u quam peshë. Nuk e mbanim dot veten, ashtu siç i ka hije një gjindjeje të kulturuar.

— Përse nuk i tundni më këmborët? — pyeta mikun para meje.

Ai më hodhi një shikim jo fort miqësor, pastaj e flaku këmborën. Ndërkohë Panua po prakti-

konte Shulcin në ushtrimet e ekuilibrit, në sprint si dhe në mbulimin dy me një.

— More, po këta luajtka bukur. Përse nuk i nxorëm rezervat apo veteranët? — buçiti zëri i Demos.

— Ky është ekipi që luajti me Anglinë? — pyeta pa ironi mikun para meje.

— I téri — ma ktheu ai pa qejf.

Atë çast ngjau ajo gjua jta e paharruar, të cilën portieri mik e priti brenda vijës fatale. Stadiumi u tud e buçiti furishëm.

— Si thua, zotéri, a nuk është gol ky? — pyeti Halimi një nga miqtë.

— Jo, nuk është gol — u përgjegj tjetri.

— Po pse, si i shënoni golat ju përpara apo pas vijës fatale? — pyeta!

— S'do mend, pas vijës fatale — u përgjegj:


— Po sa vija fatale kini ju? — pyeti i paduruar Halim.

Këtu miku u ngatërrua, diç pëshpëriti për Bekenbauerin dhe për fatin e keq, pastaj heshti i trishtuar.

Shulci, për respekt, i bënte vazhdimisht rrugë Panos, ndërsa Overati as me dylbi nuk pa nga binte porta jonë.

Për fatin «jo të keq» të miqve, loja përfundoi me barazim. Kudo filluan të djegin letra e gazeta, dhe stadiumi mori një pamje festë.

Bile Halimi hoqi edhe këmishën që ta digjte por unë dhe Demua nuk e lamë. Ai ngulte këmbë se ose do ta digjte, ose do ta hante. Atëherë ne vendosëm ta hante. E, megjithatë, ai nuk e hëngri!



Miqtë u çuan kokulur duke flakur zile e këmborë.

— Sidoqoftë ne prapë shihemi — tha miku para meje.

— Vetëm jo në eleminatore — ja ktheva unë, — ndryshe as në gjashtëmbëdhjetshe nuk do kualifikoheni dot.

Miku më pa me mosbesim, pastaj më ktheu krahët.

Si njeri me ndjenja të theksuara humanitare, më vinte keq për të. Kështu, miqtë mësuan se këmborët tona nuk i tund dot çdo dash nga Evropa!

D U E L I

Një ditë gazeta «Dejli Washington», midis lajmeve të ndryshme, jepte dhe këtë njoftim interesant.

«FTESË DUELI»

«Orkestra e xhazit «Nju Amerika» fton në duel sportivo-muzikor një orkestër evropiane, paravësish se nga cili vend.

Partnerët evropianë, po qe se marrin guximin për të dalë në fushë të mejdani, duhet të kenë parasysh këto pajime për duelin:

Katër xhezbanë, pesë klarineta, katër violina, tri oboe, trembëdhjetë saksofonë, katër piano-forte, dhe shtatë klaviçembla.

Për çdo instrument duhet të ketë nga dy instrumentistë rezervë. Ndalohet pajisja me doreza të hekurta, me pistoleta, thika apo me armë të tjera të ftohta, që mund të inkurajojnë gjakrat e nxehta.

Vendi i takimit do të jetë asnjanës dhe do të caktohet me marrëveshje dypalëshe. Ndesha e duelit zgjat tri orë e dymbëdhjetë minuta.

Në fund dueli do të mbylljet me garën karakteristike të thyerjes dhe të groposjes së pianove. Ku ne do të përpinqemi të thyejmë rekordin botëror.

Sqarimet më të hollësishme i merr përsipër gazeta «Dejli Washington».»

Ky lajmërim u botua disa herë me radhë në mjaft vende të Evropës Perëndimore.

Klarinetisti Kurt Hertman i përpiu me sy rreshtat e lajmërimit dhe gjaku i fërfelloi në rrëmba. Ai s'kish disa muaj që ish kthyer duarbosh nga Kongua. Puna e mercenarit nuk i pat dhënë rezultatet e ëndërruara.

«Këtu diçka mund të kurdiset — mendoi Kurti me vete. — Duel muzikantësh! Ky rast duhet shfrytëzuar. Këta muzikantët amerikanë si shumë arrogantë po tregohen. Megjithëse ne ua kemi thyer rekordin botëror të thyerjes së pianove, prapëseprapë nuk duan ta ulin hundën. Përse të mos ua thyejmë edhe një herë rekordin dhe hundën? Vajta kohë pa thyer një palë hundë. Si mund të rrijë njeriu kaq indiferent ndaj prestigjit nacional?»

Të nesërmen, Kurti mblođhi bandën e tij të zgjedhur. Kuptohet, këta ishin njerëz tepër të sprovuar si në hu ashtu edhe në litar.

Kapobanda u mbajti një fjalim të shkurtër, por prekës.

Muzikantët (që prej natyre i kanë telat shumë të hollë) u përlotën të gjithë nga fjala prekëse e Kurt Hertmanit.

Filloi korrespondenca për caktimin e vendit asnjanës, ku do zhvillohej dueli. Qytetet Bombei, Kalkuta, Oslo, Kopenhangen nuk u pëlqyen, njeri nga një palë e tjetri nga pala tjetër. Po ashtu nuk ranë dakord për Madridin, Barcelonën, Milanon, Brukselin dhe Montekarlon.

I dëshpëruar dhe pa shpresë, delegati amerikan propozoi Titogradin. Gjermanët e aprovuan njëzëri.

Po me marrëveshje dypalëshe u caktuan juria qendrore, arbitrat anësorë, stenografët, kronometristët, operatorët e të tjera.

Firmat e televizionit zunë radhën e abonimeve.

Erdhi dita e duelit. Qyteti i Titogradit ish stolisur që para një jave si për festën kombëtare.

Në sallën e myllur të palestrës «Jupiter», hyri në fillim juria qendrore, pastaj ekipet e të dy orkestrave, duke mbajtur në dorë flamujtë kombëtarë përkatës. Pas këtyre dolën me uniformë speciale arbitrat e panumërt, kronometristët, masazheristët, trupa sanitare dhe një togë me fotoreporterë.

Së pari u ekzekutuan himnet kombëtare të Amerikës dhe të Gjermanisë Perëndimore.

Dueli u hap me «marshin e Barbarosës», u pësua me «Ngadhënjimin e Falkonit» dhe në «Rrëzimin e Yllit» u grisën partiturat.

Dueli vijoi me flakjen e të gjitha kufizimeve të solfezhit. Çdo instrumentist ekzekutonte përhesap të vet. Kjo i nxehu më tepër gjakërat.

Të dy palët tregoheshin mjaft energjikë, mbasi kishin pirë me shumicë psikoton¹⁾.

1) lloj dopingu.

Kurt Hertmani priti me mjaft durim, por si e pa se kështu nuk dihej sa do zgjaste davaja, u hodh në aksion. Nxori pipën e klarinetës dhe, duke e kthyer instrumentin në topuz, ja hoqi kokës dirigjentit të orkestrës «Nju Amerika». Por dirigjenti vigjilent kish parashikuar çdo gjë. Ai nxori përpëra një mburojë elastike dhe, në çast, klarineta u kthye dhe u zhulat mbi kokën e të zot.

Kaq deshi puna. Vetëm xixën. Plani i përleshjes ish përpunuar me hollësi qysh më parë nga të dy palët, por këtu në fushën e mejdanit, puna nuk priste për plane dhe për taktika. Të gjithë u hodhën në sulm ashtu siç mundën.

U luftua për çdo instrument, për çdo partiturre dhe për çdo notë.

Dueli fitohej nga ai ekip, që do grumbullonte sa më shumë nga rrangullat e thyera mbi kockat dhe gjymtyrët e muzikantëve.

Nga një vështrim i përgjithshëm dhe i rrufeshëm, doli se instrumentet gjermane ishin me një konstruksion më të preqitur fizikisht. Pra, goditja me një instrument të tillë shkaktonte me siguri ose frakturë, ose hemorragji të brëndshme.

Juria, e mërzitur në rolin e saj prej vëzhguesi pasiv, u hodh në betejë. Po kështu vepruan masazheristët, fotoreporterët e kush mundi tjetër. Ndarja u bë sipas sferave të influencës, si dhe sipas simpative personale.

Kërcitjet nga thyerjet ndiheshin sa vinte më dendur, veçse nuk merrej vesh në qenë kocka apo instrumente.

Kur në sheshin e mejdanit që grumbulluar

mjaft lëndë për ndërhyrjen e trupës sanitare, kjo bëri përpara.

Në krye ecte serbes kryemjeku i trupës. Por sa hodhi dy hapa në fushën e luftimeve, ndjeu një saksafon, që i krisi mbi shpinë.

Atë kohë mjeku humanitar mbërtheu një oboe dhe iu përgjegj aq bukur atij që e sulmoi, saqë e shtriu si peshk në dysheme.

Kështu trupa sanitare filloi të japë kontributin e saj për lehtësimin e gjëndjes.

Kurt Hertmani zhvendosi një piano dhe e përmbyssi mbi duelistët, pa shikuar në qenë gjerma-në apo amerikanë. Marifeti ish të shfrente dufin pa edhe vetes sikur t'ja hiqje, pak rëndësi kish.

Të fundit që po bënin qëndresë qenë Kurt Hertmani, dirigjenti i «Nju Amerikës», si dhe kryemjeku. Mbetej pra një duel tresh i paparë gjer më atë ditë në takimet e bandave orkestrale.


Kurti nuk e llogariste fare kryemjekun, që ish nga vendi asnjanës. Ai gjithë inatin e tij e kish me kolegun amerikan. Kështu, si rrëmbeu një manjetofon, ja futi me dashamirësi kokës së kologut.

Por i shkathëti koleg u ul sakaq dhe manjetofoni u ndesh në kokën e kryemjekut, duke errësuar aty të gjitha pikëpamjet mbi humanizmin dhe mbi mjeksinë.

Mbetën të dy dirigjentët. Dueli ish me të vërtetë dinjitoz.

Rreth e rrotull të plagosurit dhe të dëmtuarit, përmes rënkimeve, nuk përtonin t'u jepnin kurajë të dy trimave.

U thyen pothuaj të gjitha instrumentet, por



asnje nga duelistët nuk kish ndër mend të dorëzohej.

Si e pa kështu, kryetari i jurisë, Fuçiqi, hyri në mes dhe i ndau duelistët. Nuk kish mbetur asnje instrument i saktë për të vazhduar ndeshjen. Pra s'kish më asnje kuptim zgjatja.

Respekti që treguan të dy muzikantët për Fuçiqin i habitit të gjithë, mbasi kushdo tjetër, që do u hynte në mes atëkohë, me siguri do palosej përtokë.

— Boll më zotërinj — tha autoritar Fuçiqi.
— Gara do vijojë me një konkurrim paqësor në magazinën e sallamerisë. Kush nga ju të dy do gëlltisë më shumë metra sallam, do të fitojë edhe kupën e duelit midis dy orkestrave.

Sapo që dueli kaloi në rrugë paqësore, gjindja e humbi interesimin pér ngadhënjyesin. Dhe jo më kot. Spektatorët e dinin fare mirë se sallameritë e qytetit kishin mbi tre javë që nuk po furnizoheshin pér mungesë malli.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kampioni i australisë	3
Të puthurat e Shefikut	11
Gladiatori i mundur	20
Goli im i vetëm	32
Rrëshqitje diagonale	39
Pas ndeshjes	46
Si u bëra kampion	53
Koha e humbur	60
Polinjeriu	66
Skandal në stadium	72
Kritika vertikale	77
Këmborët	84
Dueli	91